

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5916  
E martë, 29 tetor 2019  
çmimi 0.40 €

## Dorëzohen 102 kallëzime penale për krime të luftës në Gjakovë



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", BELUL BEQAJ



## Kosova ka nevojë për një qeveri të ndershme

- Binomi i ardhshëm Albin Kurti dhe Vjosa Osmani ka një përparësi e cila mund të shndërrohet në të metë po qe se nuk shfrytëzohet si duhet

Politologu Belul Beqaj ka thënë se rezultati i zgjedhjeve të 6 tetorit më shumë është pasojë e zhgënjimit në politikën e 'komandantëve të luftës' që kanë qeverisur kohë pas kohe edhe me zyrtarët e 'rezistencës paqësore politike' sesa e besimit në koalicionin e

ardhshëm. Megjithatë, ai ka thënë se është ndryshim i vogël që ka krijuar shpresën e madhe. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Beqaj ka deklaruar se Kosova ka nevojë për një qeveri të ndershme. Sipas tij, kësaj qeverie do t'i falej çdo gjë përpos nëse

sillet sikur qeveritë e mëparshme. Beqaj shpreson se qeveria Kurti do të jetë e ndershme, kompetente dhe e krijuar në sajë të meritokracisë profesionale. Por, sipas tij, problemi i parë do të jetë konsolidimi i suksesshëm i kabinetit qeveritar

## PZAP-i refuzon ankesën e Vetëvendosjes për votat nga diaspora

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) e ka refuzuar të pabazuar ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje për numërimin e 4 639 votave të diasporës që kanë arritur pas afatit të paraparë. Ndërkaq Lëvizja Vetëvendosje ka bërë me dije të hënën se do ta apelojë në Gjykatën Supreme vendimin për mosnumërimin e votave të diasporës



## ASK-ja e gatshme për procesin e regjistrimit të popullsisë

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## OPINION

**SHPRESA PËR NJË TË ARDHME TË MIRË PËR POPUJT EVROPIANË - KOMBIN EVROPIAN** F. 8

Shkruan: Hisen BERISHA



## AKTUALE



**KOSNETTI TAKOHET ME KURTIN, INTERESOHET PËR FORMIMIN E QEVERISË** F. 3

**SERVERI: FRANCËS DHE HOLANDËS T'I VIJË TURP SE SI VEPRUAN ME SHQIPËRINË DHE MAQEDONINË** F. 2

**QKUK-ja DHE SPITALI I FERIZAJT, ME PAJISJE TË REJA TË RËNTGENIT** F. 6

## EKONOMI

**MBI 2 200 KONSUMATORË NGA IPKO KALOJNË NË VALA** F. 9

**SOT FILLON PETICIONI PËR NDALIMIN E DEGRADIMIT TË AMBIENTIT NGA HIDROCENTRALET** F. 9

## SPORT

**KLUBET NUK E HARROJNË ZANATIN E NDËRRIMIT TË TRAJNERËVE** F.20

## Serveri: Francës dhe Holandës t'i vijë turp se si vepruan me Shqipërinë dhe Maqedoninë

PRISHTINË, 28 TETOR - Eksperti amerikan për Ballkanin, Daniel Server, i pranishëm në konferencën "Politika amerikane në Ballkanin Perëndimor", ka

thënë se Francës dhe Holandës duhet t'u vijë turp për mënyrën se si vepruan me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut për hapjen e negociatave. "Kur erdha këtu

22 vjet më parë vendi ishte në kaos total, tani vendi ka lulëzuar, tani ju keni përmbushur kriteret për t'i futur në BE. Francës dhe BE-së t'u vijë turp se si vepruan

me ju. Tani angazhohuni ndaj kërkesave. Ju mund të përparoni ende edhe pa negociatat. Vonesa nuk duhet të ndikojë në gjëra të tjera", ka thënë ai.



## Stoltenberg: Shqipëria, anëtar i besueshëm i NATO-s

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, vlerësoi rolin e Shqipërisë në NATO dhe pjesëmarrjen e saj në gjithë misionet ku është kërkuar nga aleanca dhe të gjitha këto tregojnë angazhimin e Shqipërisë në Aleancë

TIRANË, 28 TETOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta gjatë qëndrimit në Bruksel është pritur në takim zyrtar nga sekretari i përgjithshëm të Aleancës së Atlantikut të Veriut, Jens Stoltenberg.

Në një konferencë të përbashkët me gazetarë, pas takimit, presidenti Ilir Meta vlerësoi rëndësinë që ka NATO në rajonin e Ballkanit dhe në gjithë botën.

"Ne e kuptojmë mirë rëndësinë që ka aleanca në rajon", deklaroi presidenti Meta. Kreu i shtetit përmendi kontributin që

Shqipëria ka në misionet e NATO-s duke dhënë ndihmë dhe personal ushtarak, si pjesë e aleancës.

Kreu i shtetit u ndal edhe në projektin e NATO-s për të ndër-tuar bazën ajrore në Kuçovë.

Ndërkohë Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, vlerësoi rolin e Shqipërisë në NATO dhe pjesëmarrjen e saj në gjithë misionet ku është kërkuar nga aleanca.

"Ju luani rol të rëndësishëm, duke siguruar më shumë sigurinë në Ballkan. Me misionet që ka në Afganistan, për të luftuar



terrorizmin në rajonin e baltikut, duke dërguar forca në Lituani. Të gjitha këto tregojnë angazhimin e Shqipërisë në


Aleancë. NATO-ja po realizon një bazë të re në Shqipëri, që do forcojë sigurinë në vendin tuaj. Vitin tjetër Shqipëria do marrë

rol të rëndësishëm në sigurinë botërore, në OSBE. Është jetike. Bashkëpunimi i NATO-s me OSBE-në është shumë i rëndësishëm", tha Jens Stoltenbergu. Sekretari i NATO-s vlerësoi dhe investimet e Shqipërisë në fushën e mbrojtjes.

"Gjatë takimit diskutuam dhe rëndësinë e ndarjes së barrës me aleancën. Shqipëria ka investuar më shumë në mbrojtje. Diskutuam dhe situatën në Ballkanin Perëndimor. Falënderove Shqipërinë në rolin e dhënë në rajon për stabilitet dhe paqe. Shqipëria është një avokat i fortë për anëtarësimin e vendeve të tjera për në NATO. Shqipëria ka ratifikuar Protokollin e anëtarësimit për Maqedoninë e Veriut dhe pres me padurim që ky vend të anëtarësohet sa më shpejt", tha shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg.

## Rama: Mosliberalizimi i vizave për Kosovën kalon kufirin e çdo absurdi

TIRANË, 28 TETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka folur gjatë në konferencën "Politika amerikane në Ballkanin Perëndimor" për marrëdhëniet e Shqipërisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). "Prej kohësh marrëdhëniet me ShBA-në me ne nisi të plazmohej si një marrëdhënie speciale, e cila sot është në themelin e politikës sonë të jashtme si dhe në themelin e vetëdijes së shqiptarëve që jo vetëm që nuk janë



vetëm por janë në shoqërinë më të mirë të mundshme. Nëse sot ne jemi më mirë se asnjëherë tjetër, duke parë të shkuarën, kjo i dedikohet kësaj marrëdhënie dhe i shkojnë më së miri kësaj marrëdhënie fjalët e Nolit, i cili thotë për Amerikën një vend kaq i madh që udhëheq njerëzimin drejt paqes universale, demokracisë e lirisë", tha Rama. Kryeministri Edi Rama ka folur edhe për konfliktin Kosovë-Serbi, për të cilin nuk ka kursyer

vërejtjet në adresë të BE-së. "Edhe pse jemi ende larg të zgjidhje përfundimtare të paqes për sa kohë nuk ka një zgjidhje mes Serbisë dhe Kosovës, nga ana tjetër vlen të theksohet se emërimi në këtë fazë të jetës politike në rajon, të Matheë Palmer, dhe Grenell, përbëjnë një shenjë të interesimit e fokusi që është i domosdoshëm nga ShBA-ja mbi rajonin dhe këtë konflikt. Pozicioni i BE-së në këtë konflikt është tkurrur tej

mase, këtë besoj e dinë të gjithë që pas vendimit të KE më 18 tetor.

"Po bëhen disa herë që BE-ja nuk mban fjalën dhe në rastin e Kosovës kemi një nga shembujt më flagrantë për mungesën e kapacitetit për të mbajtur fjalën. E kam fjalën për kushtëzimin absurd, por që u mor ne konsideratë për liberalizimin e vizave pas kryerjes së marrëveshjes për kufirin me Malin e Zi", tha Rama.

## Diplomacia shqiptare në kolaps

TIRANË, 28 TETOR - Që prej emërimit në krye të Ministrisë së Jashtme, Gent Cakaj, deri më sot nuk ka emëruar asnjë ambasador në përfaqësitë diplomatike në botë. Kjo ka ardhur pas një konflikti, mes tij dhe presidentit Ilir Meta, për dekretimin e ambasadorëve të rinj.

Sipas Ligjit për Shërbimin e Jashtëm, të gjithë ambasadorët propozohen nga ministri i Jashtëm dhe më pas dekretohen nga presidenti i Republikës. Por, Cakaj prej kohësh nuk ka asnjë komunikim zyrtar ose jo zyrtar me presidentin Meta, për shkak se ky i fundit, refuzoi edhe vetë

dekretimin e Cakajt si ministër i Jashtëm.

U desh më pas ndërhyrja e Edi Ramës, i cili u dekretua si ministër i Jashtëm dhe i delegoi kompetencat Gent Cakajt. Që prej atij momenti, Cakaj dhe Meta nuk flasin më, madje as kur janë të pranishëm në konferenca të përbashkëta. Kulmi

arriti në Samitin e Sigurisë që u zhvillua në Gjermani në muajin shkurt të këtij viti, ku Cakaj dhe Meta ishin në një tryezë, por të dy nuk flisnin me njëri-tjetrin, duke lënë një shije të hidhur te të gjithë të pranishmit.

Konflikti mes tyre, ka shkaktuar kolaps në diplomaci, pasi një



pjesë e mirë e ambasadorëve u ka mbaruar mandati. (gsh).

# PZAP-i refuzon ankesën e Vetëvendosjes për votat nga diaspora

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) e ka refuzuar të pabazuar ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje për numërimin e 4 639 votave të diasporës që kanë arritur pas afatit të paraparë. Ndërkaq Lëvizja Vetëvendosje ka bërë me dije të hënën se do ta apelojë në Gjykatën Supreme vendimin për mosnumërimin e votave të diasporës

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 28 TETOR** - Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ka vendosur ta refuzojë ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje për numërimin të fletëvotimeve të diasporës që kanë arritur pas afatit të paraparë.

Lëvizja Vetëvendosje ka paraqitur ankesën e saj në Gjykatën Supreme përmes së cilës ka kërkuar numërimin të 4 639 votave të diasporës, kërkesë të cilën Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia e kishte hedhur poshtë, ndërsa ditë më parë Supremja ia ktheu prapa këtë vendim Panelit. Lëvizja Vetëvendosje në rast se ka ndonjë pakënaqësi me vendimin, ka kohë 24 orë për ankesë.

Lëvizja Vetëvendosje (LV) nëpërmjet një komunikate për medie ka bërë me dije të hënën se do ta apelojë në Gjykatën Supreme vendimin për mosnumërimin e votave të diasporës.

Nga momenti i pranimit të vendimit nga pala, Gjykata Supreme e Kosovës duhet të

vendosë lidhur me ankesën brenda afatit prej 72 orëve. "Sot nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia pranuan vendimin e marrë nga gjyqtarët Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Llazic, Afjete Sada-Glligjani, Kymete Kimete, Zyhdi Haziri, Rustem Thaqi, Ferki Xhaferi, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu, anëtarë, ku refuzohet i pabazuar apeli i paraqitur nga Lëvizja Vetëvendosje për numërimin e zarfeve me fletëvotime nga bashkatdhetarët tanë. Ndonëse Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës i kërkonte PZAP-it ta merrte parasysh këtë të drejtë, sërish sot ky panel në mënyrë artificiale dhe në interpretim të ngushtë ua mohoi të drejtën për numërimin e votës qytetarëve tanë që jetojnë jashtë vendit", është theksuar në komunikatën e LV-së.

Më tutje, është thënë se Lëvizja Vetëvendosje do ta dërgojë në Gjykatën Supreme apelin sërish, duke pritur që kjo çështje të zgjidhet e të numërohet këto fletëvotime. "Bashkatdhetarët tanë nuk ia kanë borxh askujt këtë cenim të së drejtës së tyre



bazike që buron nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe të drejtat ndërkombëtare në këtë sferë", është theksuar në komunikatë.

Sa i përket rezultatit përfundimtar, edhe pas procesit të rinumërimin të 530 vendvotimeve, pastaj numërimin të votave nga diaspora, atyre nga Serbia dhe votave me kusht, nuk ka ndonjë ndryshim me rezultatit preliminar të prezantuar më 7 tetor. Lëvizja Vetëvendosje mbetet subjekti që ka fituar zgjedhjet, e pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës dhe koalicioni AAK-PSD. Kurse mbetet ende të vërtetohet nëse koalicioni Nisma-AKR-PD e ka kaluar pragun zgjedhor prej 5

përqindësh. Bazuar në raportimet nga vëzhguesit vendorë dhe ata ndërkombëtarë, procesi

zgjedhor kaloi qetë dhe ishte në harmoni me standardet demokratike.

## Kryeziu: Vendim i PZAP-it, korrekt dhe profesional

Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka përgëzuar Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) lidhur me vendimin për vlefshmërinë e votave me postë të ardhura pas 6 tetorit. Ai ka thënë se ky vendim është korrekt dhe profesional. "Respektimi dhe interpretimi i saktë i ligjit nuk është disponim kundër votuesve nga diaspora, por është përkushtim dhe përgjegjësi për ta garantuar zbatimin e ligjit. Vendim korrekt dhe profesional i PZAP-së në lidhje me vlefshmërinë e votave me postë të arritura pas 6 tetorit", ka deklaruar Kryeziu pas vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) për të mos u numëruar fletëvotimet e diasporës që kanë arritur pas afatit të paraparë.

## Kosnetti takohet me Kurtin, interesohet për formimin e qeverisë

**PRISHTINË, 28 TETOR (ER)** - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, së bashku me nënkryetarin Besnik Bislimi, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e ShBA-së në Kosovë, Philip S. Kosnett, shoqëruar nga këshilltarja politike Jessica Long dhe shefja e sektorit ekonomik në Ambasadën Amerikane, Lori Michaelson.

Në këtë takim Kosnetti ka shprehur interesimin e tij për ecurinë e bisedimeve rreth formimit të qeverisë së re, duke uruar që institucionet e Republikës së Kosovës të themelohen sa më parë, në mënyrë që edhe puna për një shtet të së drejtës që lufton korrupsionin dhe zhvillon ekonominë t'i sjellë rezultatet e para.

Ndërsa shefja e sektorit ekonomik në Ambasadën Amerikane, Lori Michaelson, ka vënë theksin te rëndësia e zhvillimit ekonomik në vend, duke shprehur interesimin dhe

mbështetjen e ambasadës për projektet e qeverisë së ardhshme në këtë drejtim.

Në anën tjetër, kryetari Kurti e ka njoftuar ambasadorin Kosnett me ecurinë pozitive të takimeve me LDK-në dhe ka shprehur bindjen se shumë shpejt do të formohet qeveria e re.

Kurti ka thënë se do t'i kushtohet rëndësi sundimit të ligjit dhe luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit të lartë institucional, në mënyrë që t'i hapet kështu rrugë edhe përparimit socio-ekonomik. Përpos luftës ndaj korrupsionit, me Kosnettin dhe Michaelsonin janë ndarë idetë e LV-së për zhvillimin ekonomik të bazuar në politika mbështetëse për bizneset e vogla dhe të mesme në përgjithësi, në prodhimin vendor dhe në arsimin e lidhur me ekonominë. Ambasadori Kosnett të hënën është takuar edhe me drejtuesit e LDK-së.



Flet për "Epokën e re", Belul Beqaj

# Kosova ka nevojë për një

**- Binomi i ardhshëm Albin Kurti dhe Vjosa Osmani ka një përparësi e cila mund të shndërrohet në të metë po qe se nuk shfrytëzohet si duhet**

Politologu Belul Beqaj ka thënë se rezultati i zgjedhjeve të 6 tetorit më shumë është pasojë e zhgënjimit në politikën e 'komandantëve të luftës' që kanë qeverisur kohë pas kohe edhe me zyrtarët e 'rezistencës paqësore politike' sesa e besimit në koalicionin e ardhshëm. Megjithatë, ai ka thënë se është ndryshim i vogël që ka krijuar shpresën e madhe. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Beqaj ka deklaruar se Kosova ka nevojë për një qeveri të ndershme. Sipas tij, kësaj qeverie do t'i falej çdo gjë përpos nëse silltet sikur qeveritë e mëparshme. Beqaj shpreson se qeveria Kurti do të jetë e ndershme, kompetente dhe e krijuar në sajë të meritokracisë profesionale. Por, sipas tij, problemi i parë do të jetë konsolidimi i suksesshëm i kabinetit qeveritar



Ai thënë se shteti i Kosovës ka nevojë për një qeveri të ndershme dhe, sipas Beqajt, kësaj qeverie do t'i falej çdo gjë

përpos nëse silltet sikur qeveritë e mëparshme. "Pritja tashmë po ndodhë. Qeveria racionale me 12 ministri është indikator i

parë. Shpresoj se ajo do të jetë e ndershme, kompetente dhe e krijuar në saje të meritokracisë profesionale. Kosova ka nevojë

## **EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 28 TETOR - Politologu Belul Beqaj ka thënë të hënën se ndryshimi i vogël i 6 tetorit ka krijuar shpresën e madhe. Ai ka vlerësuar se rezultati zgjedhor më shumë është pasojë e zhgënjimit në politikën e 'komandantëve të luftës' që kanë qeverisur kohë pas kohe edhe me zyrtarët e 'rezistencës paqësore politike' sesa e besim-

it në koalicionin e ardhshëm. "Realisht, zgjedhjet janë fillim i perëndimit të gjeneratës së luftës dhe fillim i shansit për ta krijuar besimin gjenerata e politikëbërësve që nuk kanë qenë në pushtet. Koalicioni nuk është alternativ, por do të ishte mossaues nëse nuk dëshmohet si diskontinuitet! Realisht, e ardhmja po e mposhtë të kaluarën!", ka deklaruar Beqaj në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re".

## Kosnetti inkurajon LDK-në ta vazhdojë qasjen konstruktive në proceset e Kosovës

Prishtinë, 28 tetor (ER) - Nënkryetarët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Vjosa Osmani dhe Lutfi Haziri, janë takuar të hënën me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett. Gjatë këtij takimi është diskutuar për situatën aktuale politike në vend dhe për bisedimet ndërmjet LDK-së dhe LV-së për formimin e institucioneve të dala nga

zgjedhjet e tetorit 2019. "Lidhja Demokratike e Kosovës vazhdimisht shpreh mirënjohjen dhe falënderimin e veçantë për mbështetjen që i ka dhënë ShBA-ja Kosovës në të gjitha proceset shtetndërtuese. Osmani gjatë takimit ka diskutuar për prioritetet e LDK-së në institucionet e ardhshme, në veçanti për zhvillimin ekonomik, procesin e dialogut Kosovë - Serbi dhe për sundimin e ligjit dhe

ka potencuar rëndësinë e bashkërendimit të qëndrimeve me partnerët tanë, ShBA-në dhe Bashkimin Evropian", është thënë në njoftimin e LDK-së. Ambasadori Kosnett thuhet se e ka inkurajuar LDK-në ta vazhdojë qasjen konstruktive në proceset e Kosovës. Në takim të pranishëm ishin edhe anëtarët e Kryesisë së LDK-së, Kujtim Shala dhe Besian Mustafa.



# qeveri të ndershme



për një qeveri të ndershme. Kësaj qeverie do t'i falej çdo gjë përpos nëse sillet sikur qeveritë e mëparshme", është shprehur

Beqaj. Por, sipas tij, problemi i parë do të jetë konsolidimi i suksesshëm i kabinetit qeveritar. "Problemi i parë është kon-

solidimi i suksesshëm i kabinetit qeveritar, ndërsa problemi i dytë është edhe më i vështirë. Metaforikisht do të propozoja

qeverisësve të ardhshëm të mendojnë seriozisht për ta krijuar ministrinë e trembëdhjetë që do të merret vetëm me evitimin e pasojave dhe pengesave të qeveritarëve të deritanishëm", ka theksuar Beqaj.

Ai ka vlerësuar se binomi i ardhshëm Albin Kurti dhe Vjosa Osmani ka një përparësi e cila mund të shndërrohet në të metë po qe se nuk shfrytëzohet si duhet. "Fakti se ky binom nuk ka qenë në pushtetin e identifikuar me krim të organizuar dhe korrupsion ua jep përparësinë për fillim, por mungesa e përvojës qeverisëse, veçmas marrja me pasojat e politikës së trashëguar, mund t'i sfidojë karshi pritjeve të shtuara", ka deklaruar Beqaj.

**"Epoka e re":** Z. Beqaj, si e komentoni rezultatin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 6 tetorit dhe formimin e institucioneve të reja?

**Beqaj:** Rezultati zgjedhor është më shumë pasojë e zhgënjimit në politikën e 'komandantëve të luftës' që kanë qeverisur kohë pas kohe edhe me zyrtarët e 'rezistencës paqësore politike' sesa e besimit në koalicionin e ardhshëm zgjedhor. Sidoqoftë, është ndryshim i vogël që ka krijuar shpresën e madhe. Realisht, zgjedhjet janë fillim i perëndimit të gjeneratës së luftës dhe fillim i shansit për ta krijuar besimin gjenerata e politikëbërësve që nuk kanë qenë në pushtet. Koalicioni nuk është alternativ, por do të ishte mossaunses nëse nuk dëshmohej si diskontinuitet. Realisht, e ardhmja po e mposhtë të kaluarën!

**"Epoka e re":** Bazuar në këtë rezultat, Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) do ta drejtojnë qeverinë e ardhshme. Nga këndvështrimi juaj, si e shihni funksionimin e koalicionit

LV-LDK?

**Beqaj:** Binomi i ardhshëm Albin Kurti dhe Vjosa Osmani ka një përparësi e cila mund të shndërrohet në të metë po qe se nuk shfrytëzohet si duhet. Fakti se ky binom nuk ka qenë në pushtetin e identifikuar me krim të organizuar dhe korrupsion ua jep përparësinë për fillim, por mungesa e përvojës qeverisëse, veçmas marrja me pasojat e politikës së trashëguar, mund t'i sfidojë karshi pritjeve të shtuara.

**"Epoka e re":** Priten ndryshime thelbësore në Kosovë nga qeveria Kurti?

**Beqaj:** Pritja tashmë po ndodhë. Qeveria racionale me 12 ministri është indikatori i parë. Shpresoj se ajo do të jetë e ndershme, kompetente dhe e krijuar në sajë të meritokracisë profesionale.

**"Epoka e re":** Cilat mendoni se do të jenë problemet dhe sfidat me të cilat do të ballafaqohet qeveria e re?

**Beqaj:** Problemi i parë është konsolidimi i suksesshëm i kabinetit qeveritar, ndërsa problemi i dytë është edhe më i vështirë. Metaforikisht do t'u propozoja qeverisësve të ardhshëm të mendojnë seriozisht për ta krijuar ministrinë e trembëdhjetë që do të merret vetëm me evitimin e pasojave dhe pengesave të qeveritarëve të deritanishëm.

**"Epoka e re":** Ku mendoni se do të tregohet më e fortë qeveria e ardhshme? Në planin e brendshëm përfshirë sundimin e ligjit, zhvillimin ekonomik, arsimin e shëndetësinë apo në aspektin ndërkombëtar ku përfshihen dialogu me Serbinë, agjenda evropiane dhe të tjera?

**Beqaj:** Kosova ka nevojë, para së gjithash, për një qeveri të ndershme. Kësaj qeverie do t'i falej çdo gjë përpos nëse sillet sikur qeveritë e mëparshme.

## Vlerësohet siguria në Parkun Inovativ në Prizren

Prizren, 28 tetor (ER) - Në njëvjetorin e Parkut Inovativ në Prizren, projekt i përbashkët i implementimit koso-var-gjerman, të hënën u zhvillua një takim i përbashkët ndërmjet drejtorit rajonal Faton Alija dhe zyrtarit të qendrës inovative Wolfgang Leidig, përfaqësues i GIZ-it. Takimi ishte lidhur me çështjen e sigurisë në këtë zonë. Në këtë takim u vlerësua situata e sigurisë dhe shërbimet e

ofruara nga Policia e Kosovës gjatë kësaj periudhe, për të cilët përfaqësuesit e GIZ-it kanë falënderuar Policinë e Kosovës për gatishmërinë dhe aktivitetet me të cilat e kanë krijuar një klimë të qetë. Drejtori i Policisë Rajonale, së bashku me stafin, gjatë vizitës në këtë qendër inovative e kanë parë nga afër metodën e punës dhe shërbimet e sigurisë në qendër, si dhe është vizituar Qendra e Vëzhgimit e

cila monitorohet nga kamerat e sigurisë. Në fund është vlerësuar se duhet të vazhdohet bashkëpunimi i mëtutjeshëm, duke ofruar shërbime dhe bashkëpunim të ndërsjellë, duke ofruar shërbime që qendra inovative t'i kryejë detyrat pa ndonjë pengesë dhe duke dhënë kontribut në fushën e zhvillimit të bizneseve në rajonin e Prizrenit dhe më tutje.



## Begaj kërkon nga drejtorët t'i shtojnë aktivitetet për përfundimin e projekteve

**MALISHEVË, 28 TETOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve. Në këtë mbledhje drejtorët e drejtorive komunale kanë raportuar për punët dhe aktivitetet e tyre gjatë javës së kaluar dhe për planifikimet për javën në vijim.

Kryetari Begaj ka kërkuar nga drejtorët t'i shtojnë aktivitetet e tyre për përfundimin e projekteve, sidomos tek investimet kapitale, në mënyrë që të për-

fundojnë projektet që ende nuk kanë përfunduar. Po ashtu, ai ka kërkuar që të mos ketë vonesa në procedura për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve. Gjatë raportimit të drejtorëve është bërë me dije se si pasojë e mungesës së reshjeve ka rritje të kërkesave për furnizim me ujë për pije. Sa i përket realizimit të projekteve, në këtë mbledhje është theksuar se janë duke vazhduar punimet në disa prej projekteve të këtij viti, siç janë rrugët, kanalizimet dhe të tjera.



## Hoti dhe Jakupi flasin për garën e kreativitetit kulturor dhe të mendimit kritik në Shtime

**SHTIME, 28 TETOR (ER)** - Nën kryetari i Komunës së Shtimes, Rrahman Jakupi, i shoqëruar nga drejtori i Arsimit, Mensur Neziri, ai i Kulturës, Lumni Amrushi, zyrtarët Fatmire Ferati dhe Besnik Shala, kanë pritur në takim Rexhep Hotin, koordinator Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Në këtë takim Jakupi

dhe Hoti kanë biseduar rreth rrjedhës së Garës Nacionale të Kreativitetit Kulturor dhe Mendimit Kritik si dhe atë të Diturisë në Komunën e Shtimes si dhe për përgatitjet për Garën Nacionale në Sport si dhe mundësisë për bashkorganizimin e nivelit komunal të garës me komunat e Kosovës. Me këtë rast, Hoti është shprehur i lumtur me faktin që Komuna e

Shtimes ka treguar një përkushtim të jashtëzakonshëm si për organizimin e garave, po ashtu në pjesëmarrje. "Komuna juaj është shembulli më i bukur i realizimit të programit tonë", ka thënë Hoti.

Ndërsa nënkryetari i Shtimes, Rrahman Jakupi, është shprehur i kënaqur me organizimin e garave dhe pjesëmarrjen e nxënësve në këto gara.

## QKUK-ja dhe Spitali i Ferizajt, me pajisje të reja të rëntgenit

**PRISHTINË, 28 TETOR (ER)** - Mjekimi Intensiv Qendror në QKUK dhe Spitali i Përgjithshëm i Ferizajt janë pajisur me rëntgen mobilë, në kornizë të furnizimit me pajisje moderne, me synim të rritjes së kualitetit dhe shkurtimit të pritjeve nga pacientët për shërbime mjekësore.

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës ka ndarë më shumë se 90 mijë euro për

këto dy pajisje, me të cilat stafi shëndetësor do ta fillojë punën shumë shpejt.


Furnizimi i Qendrës Klinike Universitare dhe spitaleve të përgjithshme me aparaturë të re është parë si nevojë e domosdoshme nga menaxhmenti i ShSKUK-së për ta përmirësuar gjendjen në ofrimin e shërbimeve dhe përmirësimin të kushteve të punës për profesionistët shëndetësorë.



## KRU 'Hidrodrini' fillon shkurtime, apelon qytetarët për kursim të ujit të pijshëm

**PEJË, 28 TETOR (ER)** - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidrodrini" ka njoftuar konsumatorët e rajonit të Pejës dhe komunave që mbulon, se si rezultat i mungesës së gjatë të reshjeve atmosferike, nga thatësira e muajit shtator dhe tetor, është krijuar rënie e sasisë së ujit nëpër burime dhe kjo ka shtyrë që kompania t'i nis shkurtime me furnizim të ujit.

Sipas kësaj kompanie, ndërprerjet do të vazhdojnë deri në



njoftimin e radhës. "KRU 'Hidrodrini' po bën përpjekje maksimale që këtë situatë ta

tejkalojë me sa më pak mungesë të ujit të pijshëm për konsumatorët. Edhe një herë, qytetarët e rajonit të Pejës, respektivisht konsumatorët, janë të lutur që sasinë e ujit ta përdorin racionalisht. Një gjë e tillë do ta lehtësonte furnizimin proporcional me ujë për të gjithë dhe do të ndikonte në zbutjen e reduktimeve. Reduktimet do të vazhdojnë deri në njoftimin e radhës", thuhet në njoftimin e KRU "Hidrodrini".



## Rreth 3 000 studentë përfituan nga programi Erasmus+

PRISHTINË, 28 TETOR (ER) - Zyra e Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë në bashkëpunim me Zyrën e Erasmus+ në Kosovë dhe Ministrinë e Arsimit kanë organizuar të hënën ditën qendrore informuese për Programin Erasmus+.

Zëvendëshefi i Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Ricardo Serri, ka thënë se programi Erasmus+ është një nga sukseset më të mëdha të BE-së. Ai ka treguar se brenda katër vjetëve rreth 3 000 studentë kanë përfituar nga ky program. "Ka

një numër të madh të studentëve që kanë pasur mundësinë që të mësojnë një kulturë dhe gjuhë tjetër dhe të kthehen në vendin e tyre. Buxheti për tre vjetët e ardhshëm do të dyfishohet. Që nga viti 2015 gati 3 000 studentë nga Kosova kanë përfituar nga ky program. Është e rëndësishme që rreth një mijë studentë kanë ardhur në Kosovë. Erasmus+ është shembulli më i mirë i shkëmbimeve", ka thënë Serri. Ai ka thënë se Kosova deri më tani ka marrë pjesë në 20 projekte për ngritjen

e arsimit dhe, sipas Serri, Erasmus+ është mundësi për zhvillimin personal dhe atyre të institucioneve.

Serri u ka rekomanduar pjesëmarrësve që të bëjnë përpjekje për të qenë përfitues i këtij programi. Ndërsa ushtruesi i detyrës së drejtorit të Departamentit për Arsimin e Lartë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Burim Gashi, është zotuar se do të përkrahin edhe më tutje këtë program me qëllim të përfitimit të studentëve.



## Dorëzohen 102 kallëzime penale për krime të luftës në Gjakovë

Shoqata për Krimet e Luftës "Gjakova '98-'99" ka dorëzuar 102 kallëzime penale ndaj serbëve për krime lufte në Komunën e Gjakovës. Dorëzimi i këtyre padive është bërë të hënën në Departamentin për Krime Lufte në Policinë e Kosovës. Kryetarja e Shoqatës "Gjakova '98-'99", Shkëndije Hoda, ka treguar se këto dosje përmbajnë materiale me dëshmi që do t'u ndihmojnë hetuesve për zbardhjen e vrasjeve gjatë luftës në Komunën e Gjakovës



**EPOKA  
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 28 TETOR - Shoqata për Krimet e Luftës, "Gjakova '98-'99", të hënën ka dorëzuar 102 kallëzime penale në Departamentin për Krime Lufte në Policinë e Kosovës. Kryetarja e kësaj Shoqate, Shkëndije Hoda, ka bërë me dije se dosjet e dorëzuara përmbajnë materiale me dëshmi dhe dokumentacione të rëndësishme që do t'u ndihmojnë hetuesve për zbardhjen e vrasjeve dhe të dhunës së ushtruar ndaj popullatës civile nga forcat policore e paramilitare serbe në luftën e viteve 1998-1999 në Komunën e Gjakovës. "Sot arritëm ta sjellim kontingjentin e 13, ku janë

të përfshira 102 lënë që do të hetohen për krime të luftës në Komunën e Gjakovës. Rastet janë të ndryshme, prej maltretimeve fizike, vrasjeve e deri te shkatërrimi i pasurisë. Do të thotë, janë të gjitha ato çfarë na kanë lënë pasoja në luftën e viteve 1998-1999", ka deklaruar Hoda, duke shtuar se e vërteta do të zbardhet dhe do të ndëshkohen kriminelët. "Ky është bashkëpunimi i parë me Policinë e Kosovës. Ne po i japim më shumë dëshmi rreth një krimi. Policia ka vullnet dhe shpresojmë të kemi një rezultat pozitiv", ka theksuar Hoda.

Ajo ka treguar se Shoqata për Krimet e Luftës "Gjakova '98-'99" edhe në të kaluarën ka dorëzuar kallëzime penale në

institucionet e drejtësisë në Kosovë mirëpo, sipas Hodës, ende nuk ka ndonjë rezultat konkret. "Njëherë përnjëherë nuk kemi asgjë. Po shihet se vullneti është shumë i madh dhe veprimi i policisë në Komunën e Gjakovës është

shumë i madh. Veprohet çdo ditë. Çdo ditë merren dëshmitarët në pyetje dhe kjo na bën të besojmë se një e ardhme shumë e shpejt do të jetë shumë pozitive", është shprehur Hoda. Gjakova është një nga komunat

që ka pësuar më së shumti dëme gjatë periudhës së luftës së fundit në Kosovë pasi në këtë kohë janë vrarë më shumë se 1 200 persona. Po ashtu, Komuna e Gjakovës ka numrin më të madh të personave të pagjetur.

## Sot nis fushata e vaksinimit të kafshëve të egra kundër tërbimit

PRISHTINË, 28 TETOR (ER) - Autoriteti i Aviacionit Civil informon të gjithë qytetarët se nga data 29 tetor deri më 4 nëntor në territorin e Republikës së Kosovës do të zhvillohet fushata e vaksinimit të kafshëve të egra kundër tërbimit. Kjo fushatë zhvillohet në tërë Ballkanin Perëndimor si

pjesë e iniciativës rajonale të kontrollit të kësaj sëmundjeje, prandaj do të ketë edhe fluturime të aeroplanëve afër zonave kufitare të Republikës së Kosovës. "Kjo fushatë e mbështetur nga Bashkimi Evropian do të zbatohet në procedurë moderne e cila garanton vaksinimin e sigurt të

kafshëve të egra, kurse i gjithë procesi i shpërndarjes së vaksinimit do të realizohet përmes ajrit dhe në mënyrë të kontrolluar nëpër të gjitha zonat malore, duke përjashtuar qendrat urbane dhe sipërfaqet ujore", është bërë me dije në njoftimin e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.



# Shpresa për një të ardhme të mirë për popujt evropianë - kombin evropian



Shkruan: Hisen BERISHA

Teoritë shkencore njohin komunitet /racat e njerëzve që tashmë mund të grupohen në dy lloje: ato të lashta dhe ato historike apo që janë në formim ose janë përfunduar si proces i formimit të tyre. Me këtë dhe duke u nisur nga fakti se racat e lashta, po t'i shohim në kontekst të tre faktorëve determinues të ekzistencës apo mbijetesës së tyre, siç janë: pabarazia numerike; dallueshmëria, në shenjat e tyre dalluese psikologjike; të jetuarit gjatë në ambient të njëjtë mjedisor fizik a moral, janë unike në koekzistencën e tyre, ndaj është e vështirë që në mesin e popujve të qytetëruar të takojmë raca të vërteta apo të pastra. Por, kemi të bëjmë më shumë me raca historike apo të krijuara nga dukuritë sociale si pushtimet, emigrimet, politikat etj. dhe të formuara me përzjerjen e njerëzve, përkatësisht kryqëzimet e racave dhe pretendimi për të krijuar një komunitet të vetëm historik që ka shenja të përbashkëta psikologjike, si ne rastin e Bashkimit Evropian. Kryqëzimi i popujve si proces i ndryshimit të strukturës së tyre fizike dhe shpirtërore si e vetmja formë për ta sfiduar konsistencën e trashëgimisë, është komponentë mjaft e fortë për t'u luftuar me trashëgimi. Përmes këtyre formave pretendohet që të zhduket shpirti i këtyre komuniteteve /racave si tërësi e ideve dhe ndjenjave të përbashkëta që përbëjnë fuqinë e popujve, pa të cilat nuk mund të ekzistojnë as kombi e as atdheu.

Kjo formulë u pretendua të aplikohet ndaj racës së shqiptarëve nga regjimi i ngrehinës artificiale federatës jugosllave, e cila, ashtu si të gjitha perandoritë e mëdha që i njeh historia, që bashkonin popuj të ndryshëm e shumë të dallueshëm, e që ishte krejt e

pamundur të jetonin nën të njëjtat institucione e ligje, ashtu siç u krijuan me forcë, ishin të destinuara edhe të shembeshin nga dhuna. Këtë fat pati edhe federata e bashkuar e popujve sllavë, që kishin dallueshmëri të thellë me popullin vendës dhe, për ironi të teorive shkencore, qëndronin më lart sesa pushtuesit. Kjo lartësi gjenetike, kulturore dhe psikologjike e komunitetit /racës vendëse (shqiptarëve) ndaj barbarëve sllavë të shekujve VI dhe VII si dhe me theks IX dhe XI, arriti që t'i bëjë të njëjtët inekzistent konceptualisht, me të prekë në vlerat e trashëgimisë sonë gjenetike, shenjat e trashëguara që na dallonin prej tyre dhe reagim jo të qytetëruar ndaj trashëgimisë sonë. Pra, vandalët sllavë nga Karpatet nuk ishin mjaftueshëm të kulturuar që të sillëshin apo të vepronin me kujdes ashtu siç u treguan të kujdesshëm dhe vepruan anglezët me kolonitë e tyre afrikano-aziatike, duke u vunë kufizime veç në vjeljen e taksës, pa u përzjer në lirinë e organizimit të jetës dhe udhëheqjes. Prandaj ja ku përfunduan "federalistët" titist serbosllavë. Ne ishim një popull i lashtë me proces të përfunduar të identitetit gjenetik racor, si dhe duke iu falënderuar edhe kufizimeve në martesë e përzjerje kulturore tradicionale si nga religjionet që dominonin në popullin tonë ashtu edhe nga kodi gjenetik nacional. Për shkak të qëndrimit të gjatë si pushtues, pushtues të ndryshëm lanë elemente të "qytetërimit" të tyre animal, që asnjëherë nuk mundi të integrohej në asnjë element të kulturës sonë autentike, lanë elemente të gjuhës së tyre që i trajtojmë si barbarizma dhe po zhduken me kohën, por asnjëherë nuk arritën të lënë te ne gjakun e tyre. Edhe po të ndodhte kjo, atëherë si metistë me trashëgimi antagoniste nuk arritën të kurojnë as të mbajnë gjallë ndonjë lloj qytetërimi. Nga jeta njohim shumë metistë që dolën nga kryqëzimet e tilla siç, ta zëmë, ndodhi në rastin e përzjerjes racore serbo-cigane trashëgimitë antagoniste të të cilëve iu shpërbën

moralitetin dhe karakterin e tyre dhe prodhuan metistë siç dëshmohet në praktikë rasti i ministrit serb të Mbrojtjes, Vulin dhe vetë presidentit serb Vuçiq.

Pra, në trevat e Ilirisë, me të rënë në kontakt me racën e lartë iliro-pellazge, iu ndodhi më shumë "aklimatizimi egjiptian" dhe, si të tillë, më lehtë do të përballen me zhdukjen e tyre. Historia e njeh koncentrimin e tyre në pashallëkun e Beogradit trashëgimi nga Turqia. Këtë e dëshmon dhe fenomeni maqedonas i deklarimit të përkatësisë edhe pas 100 vjetëve koekzistencë në identitet artificial. Si shembull kemi deklarimin e përkatësisë së tyre nga ana e kryeministrave maqedonas se janë bullgarë apo shqiptarë ortodoksë apo të akademikëve maqedonas, se janë shqiptarë apo shqiptarë ortodoksë, ministrit grek të Punëve të Jashtme që deklaroi se është arvanitas etj. Janë këto elemente progresive midis racave të larta siç historia i njeh arianët dhe iliro-pellazgët, gjegjësisht shqiptarët që janë afër njëri-tjetrit, siç janë, bie fjala, anglezët dhe gjermanët në Amerikën e sotme.

Lashtësia e racës shqiptare konfirmohet jo vetëm me vlerat etnogjenetike, por edhe në aspektin onomastik të toponimisë së territorit ku janë zhvilluar si racë e lashtë, e të cilat toponime në Evropë, Afrikë dhe Azi deshifrohen vetëm në pellazgjishte, përkatësisht shqipen e sotme. E duke e konsideruar gjuhën si ndër elementet me të cilën identifikohet komuniteti/raca, përfitojmë edhe një element shtesë që konfirmon lashtësinë e racës dhe procesin tashmë të përmbyllur të formësimit të identitetit racor. E vësimta e komuniteti/racës shqiptare është se, për dallim nga racat e tjera në kontinentet e Afrikës dhe Azisë që kanë mbijetuar falë kriterit numerik, komuniteti/raca shqiptare u ka rezistuar kryqëzimeve racore, me elementet dalluese psikologjike dhe vlerave nacionale unike. Faktorët onomastikë që përforcojnë lashtësinë e racës sonë si komunitet, edhe sot po tremb komunitetin evropian.

"Një popull mund të durojë shumë katastrofa e prapë të jetë në gjendje të ngihet në këmbë, por ai do të humbas çdo gjë e nuk do të ngrihet dot kurrë më po që se humbet shpirtin".

Këtë element të kombit shqiptar nuk arritën ta ndryshojë asnjë pushtues dhe as eksperimentuesit e tipit të federatës jugosllave. Kjo as si mjedis fizik dhe as si mjedis moral, nuk ka arritur të ndikojë në devijimin - kryqëzimin tonë racor si racë e lartë dhe tashmë e formuar prej shumë kohësh përmes trashëgimisë. Mbase këta komponentë edhe bëjnë të frikshëm për t'u integruar në BE si grumbull popujsh të kryqëzuar apo që po eksperimentohet të kryqëzohen duke asgjësuar së pari shenjat psikologjike të trashëguara nga të parët për të krijuar një "tabula rosa" tek e cila veprimi i mjedisit gradualisht forcon shenjat e reja psikologjike. Pra, vetëm kjo formë është dhe rruga e formimit të një race të re historike që do të quhej Bashkimi Evropian apo populli evropian apo European-ët. Nga kjo del se ndikimi i mjedisit fizik dhe moral është shumë i fortë te popujt apo kombet në formim.

Por si qëndron kjo te popujt evropianë? Kjo në Evropën me shumë trashëgimi kulturore, politike dhe historike do të jetë proces i komplikuar meqë nuk ka popull evropian të mos jetë formuar nga elemente të popujve të tjerë. Ndaj dhe kjo është një periudhë me grindje të brendshme e lloj-lloj të papriturash që vazhdon deri në forcimin e shenjave të reja psikologjike. Pra, krijimi komuniteteve të reja në nivel evropian duhet të jetë një proces gradual. Por, përjashtimi nga integrimi i disa komuniteteve rajonale si ne shqiptarëve, por edhe turqve etj. që hyjnë në kombe të lashta dhe të përmbyllur tashmë të procesit të komb formimit, nuk e ndihmon BE-në dhe prolongimi pa kufi i këtij procesi do ta stërkeq vetë komunitetin evropian në formim i cili, duke mos e shmangur dot kontaktin me komunitete/raca të lashta, do ta rrezikojë vetë zhdukjen në vend të konsolidimit si nocion. Kjo është treguar edhe

me historinë e formimit të perandorive të mëdha nga raca të ndryshme e që zhdukeshin me themeluesin e tyre.

Komuniteti ndërkombëtar nën ombrellën e UN, përmes krijesës UNMIK, në Kosovën e pas luftës u mundua që ta zbatojë formalen angleze dhe holandeze që përdorën ndaj popujve aziatikë, që ua respektonin atyre traditat, zakonet, ligjet e atyre popujve dhe duke i lënë për ta drejtuar vetveten, por duke kufizuar rolin e tyre vetëm në vjeljen e taksës, marrëveshjeve tregtare dhe ruajtjen e paqes që u duhet për vete dhe për të operuar në eksperimentin që zbatuan atje. Në Kosovë u aplikua e njëjta formulë, duke pretenduar edhe kryqëzimin e racave të cilat i krijuan artificialisht diku dhjetëra komunitete inekzistente asnjëherë gjatë historisë dhe si të tilla e në formim përballë një race të lashtë pellazgo-llire as që do të arrijnë të identifikohem me asgjë, do të përfundojnë në një aklimatizim egjiptian, apo edhe më tragjikisht siç përfunduan ngrehinat perandorake të krijuara me bashkimin e popujve të ndryshëm me forcë dhe janë të destinuara të shembën po nga dhuna një ditë.

Që BE-ja të formohet e të ekzistojë për një kohë të gjatë duhet të formohet ngadalë, me përzjerjen graduale të komuniteteve/racave pak të dallueshme nga njëra-tjetra, që kryqëzohen vazhdimisht me njëra-tjetrën, që banojnë në të zëjtin territor, që i nënshtrohen veprimt të të njëjtë mjedis, që kanë të njëjtat institucione dhe besime. Këto raca mundën pastaj që pas disa shekujsh të formojnë një komb të veçantë. Edhe pse duhet pasur në konsideratë studiuesit dhe ideatorët e këtyre kryqëzimeve, se ndërkohë që bota plaket, komunitetet /raca bëhen gjithnjë e më të qëndrueshme dhe ndryshimet e tyre me anë të përzjerjeve gjithmonë e më të rralla, ndaj edhe formimi i racave historike do të përfundojë.

## Ndalohejt një person për kontrabandë të migrantëve

GJILAN, 28 TETOR (ER) - Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, ka ndaluar të dyshuarin K. Sh. në kohëzgjatje prej 48 orësh, me dyshimin se ka kryer veprat penale "kontrabandimi i migrantëve" dhe "posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge", të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. "Ekziston dyshimi i bazuar që më 19 tetor 2019, rreth

orës 21:50 minuta, në Pikën Kufitare 'Dheu i Bardhë', i dyshuari K. Sh., me qëllim të përfitimit pasuror, ka tentuar të kryejë kontrabandë të migrantëve, në atë mënyrë që i dëmtuari R. O. paraprakisht kishte kontaktuar me të dyshuarin, i cili i kishte premtuar se do t'ia organizonte udhëtimin dhe do ta dërgonte në shtetet perëndimore, përkatësisht në Belgjikë, pasi nuk posedonte dokumente të vlefshme për këtë

udhëtim, ku për të gjitha këto shërbime i njëjti duhej ta paguante shumën prej 3 500 eurosh pasi të arrinte në Belgjikë", është bërë me dije në njoftimin për media të Prokurorisë Themelore në Gjilan.

Në këtë njoftim theksohet se i dyshuari K. Sh. pa autorizim ka poseduar substanca narkotike, ashtu që me rastin e kontrollimit nga ana e zyrtarëve doganorë, në veturën e tij janë gjetur 3.6 gramë



substancë narkotike e llojit 'kokainë'. "Prokurori i rastit brennda afatit ligjor do të vendosë mbi masën e sigurisë së të pandehurit,

me qëllim të zbatimit të suksesshëm të procedurës penale", është thënë në njoftimin për media.



## Mbi 2 200 konsumatorë nga IPKO kalojnë në VALA

PRISHTINË, 28 TETOR (ER) - "Telekomi i Kosovës e ka bindur me ofertat dhe shërbimet Komunën e Mitrovicës që të kalojë nga IPKO te VALA për së paku dy vjetet e ardhshëm. Për një kohë të gjatë ky institucion ka pasur në përdorim numra dhe shërbime të operatorit konkurrent", kështu ka bërë me dije kryeshefi i Telekomit Bedri Istrefi. Ai ka thënë se marrëveshja e bashkëpunimit për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese është nënshkruar nga nënkryetari i komunës,

Faruk Mujka dhe zëvendës drejtoresha e shitjes në Telekomin e Kosovës, Apollonia Ramadani. Istrefi ka thënë se me nënshkrimin e kësaj marrëveshje Komuna e Mitrovicës dhe Telekomit i Kosovës konfirmojnë pajtueshmërinë e tyre të plotë të kësaj kontrate publike, dokumentet e saj përbërëse, duke përfshirë edhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve. Me këtë rast, nënkryetari i komunës, Faruk Mujka, e ka vlerësuar të suksesshme arritjen e kësaj mar-

rëveshje, duke thënë se do të mundësohet komunikimi i tërë personelit të komunës sonë, me qëllim të ofrimin të shërbimeve sa më cilësore për qytetarët tanë. Ndërsa zëvendës drejtoresha e Telekomit, Apollonia Ramadani, u zotua se shërbimet që ofrohen nga Vala do të jenë kualitative. Kontribut të jashtëzakonshëm për arritjen e kësaj marrëveshje ka dhënë menaxheri regional në Mitrovicë, Esat Jusufi. Me këtë kontratë shërbime të Telekomit të Kosovës dhe me numra të Valës do të marrin të



gjithë punonjësit e Komunës së Mitrovicës, ku përfshihen institucionet shëndetësore, arsimore, të kulturës, zjar-

rfikësit dhe të gjithë punonjësit e tjerë që bëjnë pjesë në administrimin e kësaj komune.

# ASK-ja e gatshme për procesin e regjistrimit të popullsisë

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 TETOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka organizuar të hënën konferencë për të njoftuar rreth përgatitjeve për realizimin e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në vitin 2021.

Qëllimi i kësaj konference ishte njohja me procesin e regjistrimit të popullsisë, përfshirë sfidat dhe rezultatet që priten nga ky proces.

Isa Krasniqi, kryeshef ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, ka folur për rolin

thelbësor të regjistrimit të popullsisë 2021 për Republikën e Kosovës në integrimet euroatlantike. "ASK-ja sipas statistikave në bazë të përgjegjësisë ka bërë përgatitjet sa më mirë. Për regjistrim kemi filluar para dy vjetëve përgatitjet e para. Jemi në proces dhe hapat janë sipas planifikimeve në momentin e fundit dhe sfidat që na paraqiten do t'i zgjedhim së bashku. Regjistrimi është përgjegjësi e ASK-së, por kërkon angazhim edhe të institucioneve të tjera dhe rëndësia e të pasurit të dhëna të rëndësishme është kuciale. Konsiderojmë se edhe

angazhimi i institucioneve të tjera është i madh. Jemi në fund të procesit të koncept-dokumentit që duhet të aprovohet nga qeveria. Është pothuajse i finalizuar, por pret miratimin e qeverisë dhe të Kuvendit", ka thënë ai.

Ai ka bërë thirrje që sa më shpejt të themelohen institucionet e reja dhe të merren me miratimin e konceptdokumentit dhe draftligjit për regjistrimin e popullsisë. "E rëndësishme t'i kemi institucionet e reja, qeverinë në funksion që duhet të merret me miratim e konceptdokumentit dhe draftligjit, Kuvendin ta

aprovonë ligjin. Kemi vonesa në këtë aspekt. Në bazë të rezultateve do të jenë të dhëna të rëndësishme për vendin tonë. Rëndësia e këtyre të dhënave është shumë e rëndësishme për kuptimin e zhvillimit të politikave në këtë drejtim, sepse jemi në regjistrim pas 10 vjetëve, pasi i fundit ishte në 2011-n. Këto do të jenë të rëndësishme në politikbërje, ministri, aspekte sociale", ka thënë Krasniqi.

Avni Kastrati, drejtor i Statistikave Sociale, menaxher i regjistrimit të popullsisë 2021, ka thënë se ky regjistrim do të jetë shumë i rëndësishëm, një projekt multidi-

mensional, numëruar i vetëm për shumë indikatorë.

Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, sipas standardeve dhe praktikave ndërkombëtare, duhet të realizohet së paku çdo 10 vjet. Bazuar në këtë, sipas ASK-së, edhe Kosova do të jetë pjesë e këtij raundi të regjistrimeve.

Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë është planifikuar të mbahet në muajin prill të vitit 2021 në të njëjtin periudhë me regjistrimet që do të realizohen në vendet e tjera të Evropës dhe Botës.



## Sot fillon peticioni për ndalimin e degradimit të ambientit nga hidrocentralet

PRISHTINË, 28 TETOR (ER) - Sot (e martë) në orën 12:00 në Sheshin "Skënderbeu" fillon nënshkrimi i peticionit, nëpërmjet të cilit qytetarët e Kosovës u kërkojnë institucioneve më të larta të vendit që ta ndalin degradimin e mëtutjeshëm të ambientit nga minihidrocentralet dhe hidro-

centralet e vogla. "Shkatërrimi i vazhdueshëm i resurseve tona natyrore nga të gjithë ata që abuzojnë dhe shfrytëzojnë resurset e vendit për përfitime individuale, qofshin vendim-marrës apo investitorë, na shtyn të protestojmë dhe të premtojmë se nuk do të ndalemi.

Argumentet e mbledhura dëshmojnë se nëse nuk veprojmë tash dhe menjëherë, lumenjtë e Kosovës, si dhe popullata që jeton në afërsi të tyre, do të shkatërrohen dhe degradohen në pakshim", është thënë në njoftimin për media të tetë organizatave joqeveritare.



# RAPORTI I INSTITUTIT ZVICERAN PËR R

**Gazeta "Epoka e re" në vazhdimë do t'i botojë dy raportet e përkthyer në gjuhën shqipe, njërin prej 44 faqesh dhe tjetrin prej 15 faqesh, të Institutit të Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës, për rastin e Astrit Deharit. Këto dy raporte tashmë i ka Prokuroria Themelore në Prizren, familja e Astrit Deharit dhe avokati Tomë Gashi. Raporti publikohet pa asnjë ndërhyrje.**

Z. MAKOLLI thotë se z. DEHARI është rruar gjatë dushit por nuk është prerë. Brisqet e rrojës na ofrohen nga gardianët dhe duhet që tua dorëzojmë pas dushit. Ai saktëson se ndodh nganjëherë për ta fshehur dhe të ruhen brisqet e rrojës në qeli.

Z. MAKOLLI shtoi se dy javë më herët, z. DEHARI i kërkoi atij numrin e të afërmeve të tij duke kërkuar që do t'u telefonojë nëse ndodh diçka. Ai shton se z. DEHARI nuk kishte presion nga askush, qoftë edhe nga gardianët.

**PV e audiencës së z. MAKOLLI Naser i 18 nëntorit 2016 – i mbajtur në të njëjtën qeli me z. DEHARI Astrit.**

Z. MAKOLLI mbahej në qelinë A3 krahu A të qendrës së paraburgimit të Prizrenit që prej 8 muajsh. Z. DEHARI ishte në qelinë e njëjtë që prej 2 muajsh dhe që prej një muaji, kishin edhe dy të mbajtur tjerë. Z. LASKI dhe Z. GASHI.

Sa u përket ngjarjeve të 05 nëntorit 2016, z. MAKOLLI tregon se pas drekës, gardiani i ka hapur dyert dhe ka thënë se duhet të shkojnë për të bërë dush. Të mbajturit i kanë lëshuar qelitë e tyre dhe janë vendosur në tualetet e krahu C të qendrës së paraburgimit, të shoqëruar nga gardiani, z. KASTRATI. Pas dushit, ata sërish janë kthyer në qelitë e tyre për t'u ndërruar dhe pas 1 ore më vonë, rreth orës 14:00 gardiani ka ardhur dhe e ka hapur derën e qelisë në mënyrë që dalim në shëtitje. Në momentin e daljes njëri nga të mbajturit e ka pyetur z. DEHARI se a do të vijë dhe ky i fundit iu ka përgjigjur se nuk dëshiron të dalë me ta sepse kishte dhimbje koke, nuk ndjehej mirë dhe në mes tjerash ai parashikonte të bënte një telefonatë. Të mbajturit tjerë kanë dalë për të shëtitur dhe janë kthyer në qeli rreth orës 15:00. Z. MAKOLLI ishte i pari që hyri në qeli, të tjerët ishin prapa tij. Ai e ka parë z. DEHARI të shtrirë mbi tokë në shpinë, kokën e kthyer lehtësisht majtas, me një shishe [shënim i ekspertëve: pa saktësi tjerë]. Ai ishte i lagur në pjesën e prapme të trupi të tij. Në këtë moment z. MAKOLLI ka thirrur: "shpejt thirrni mjekun ose kë do". Gardiani "Daut" [shënim i ekspertëve: z. KASTRATI] ka ardhur menjëherë dhe posa e pa z. DEHARI Astrit në këtë gjendje, ai i urdhëroi të mbajturit të dalin shpejt nga dhoma pastaj ai ka hyrë për ta vërtetuar gjendjen e z. DEHARI, e ka prekur faqen e tij dhe ia mori pulsën. Pastaj, ai i urdhëroi ata ta transferojnë z. DEHARI në sallën mjekësore të qendrës së paraburgimit sepse ende kishte puls. z. DEHARI kishte shkruar në bllokun e adresave të z. MAKOLLI, një seri numrash të telefonit të antarëve të familjes së tij dhe miqve të tij. Arsyja për këtë ishte se z. DEHARI dëshironte që z. MAKOLLI ta njoftonte rrethin e tij në rast të transferimit nga burgu për hetime nga ana e policisë ose të Ministrisë publike. Duhej të lajmërohej edhe avokati i tij.

**PV e audiencës së z. MAKOLLI Naser i 02 dhjetor 2016 – i mbajtur në të njëjtën qeli me z. DEHARI Astrit.**

Në momentin e dëgjimit, z. MAKOLLI deklaroi se në qelinë A3, ai kishte fshehur një telefon që e përdorte ai vetë dhe z. GASHI Adonis dhe z. DEHARI Astrit. Por z. DEHARI Astrit kurrë nuk e kishte përdorur këtë telefon.

**PV e audiencës së z. LASKI Frrok i 05 nëntorit 2016 – i mbajtur në të njëjtën qeli me z. DEHARI Astrit.**

Z. LASKI deklaroi se ka qenë i mbajtur në qelinë A3 gjatë dy javëve. Gjatë kësaj kohe, ai ka pasur mundësi ta njohë z. DEHARI sipas tij ai nuk ka qenë një person i qetë dhe i lumtur. Gjatë kësaj kohe, ai nuk ka treguar asnjë shenjë që do të mund të bënin të mendohet se mund t'i bënte veti keq. Kemi të bëjmë me një intelektual i cili kishte lidhje të mira me të gjithë. Ai nuk zihej me askënd, përfshirë edhe gardianët, me të cilët kishte raporte të mira. Më 05 nëntor 2016, z. DEHARI nuk ka dalë ndërmjet orës 14:00 dhe 15:00 pasi që nuk ndihej mirë. Në momentin e kthimit të tyre në qeli, me tu hapur dera e qelisë, z. LASKI ka konstatuar se z. DEHARI pushonte i shtrirë mbi tokë dhe se kishte një shishe të vogël mjalti në gojë. Shishja ishte futur thellë në nivelin e fytyrës. Ai menjëherë e ka thirrur gardianin "Daut" [shënim i ekspertëve: z. KASTRATI] i cili erdhi. Personi mjekësor i qendrës është informuar dhe pohoi se z. DEHARI kishte një puls dhe se do të transferohej në mënyrë që të gëzon një trajtim. Ai ka vërejtur se z. DEHARI kishte një prerje pranë dorës së majtë. Nuk kishte gjak në vendin e ngjarjes apo mbi trup dhe se ai nuk ka vërejtur ndonjë instrument që do ta lëndonte pranë trupit. Z. DEHARI kishte marrëdhënie shumë të mira edhe me familjen e tij.

**PV e audiencës së z. LASKI Frrok i 10 nëntorit 2016 – i mbajtur në të njëjtën qeli me z. DEHARI Astrit.**

Z. LASKI i kujtohet se pasi që janë kthyer nga dushi, nuk ishte askush në qeli. Z. DEHARI shëtitte dhe këndonte në qeli. Z. LASKI ka dalë me Adonisin dhe Naserin në ora 14:00 dhe është kthyer në ora 15:00. Për ndryshe, Astriti ka kërkuar të qëndrojë në qeli sepse nuk ndjehej mirë. Z. LASKI nuk e ka dëgjuar të thoshte kështu, por këtë shpjegim e ka dëgjuar nga të mbajturit tjerë. Gardiani e ka mbyll derën e qelisë. Ai shton se dera e qelisë nuk mund të hapet nga brenda por vetëm nga jashtë. Pas një ore shëtitjeje, tre të mbajturit janë drejtuar për në qeli. Ky apo Naseri e kanë hapur derën. Kur ka hyrë ai ka vërejtur Astritin shtrirë mbi tokë në shpinë me duar të hapura, ai ishte i lagur në nivelin gjenital, dora e tij e majtë kishte gërvishje, mangët e tij ishin përvjelë deri në gjysmën e dorës dhe ora ishte pranë kyçit të dorës. Ndër të tjera, ai ka konstatuar se Astriti kishte një shishe prej plastike e mbushur për gjysmë me mjaltë, në gojë. Shishja kishte një kapak të verdhë. "Dauti" (gardiani) e ka tërhequr shishen nga goja e Astritit. Sipas intervenimeve të para të teknikëve mjekësorë, z. DEHARI tregonte ende shenja jete. Sa i përket këtyrë, ai nuk e di se tregonte shenja jete por ai ka vërejtur se ishte i zbehtë. Ai nuk di si ta përshkruajë situatën ndryshe. Astriti ka qenë një person i qetë dhe i rezervuar, ai shkruante letra, lexonte romane, gazeta, ishte i vetmi që shkruante letra në qeli. Ai ishte një person serioz, por ishte shumë komunikativ, i gatshëm për të ndihmuar. Ai e ka përmendur të vëllain vetëm njëherë, duke thënë se ishte i vdekur.

Në pyetjen se a e dinte se z. DEHARI vuante nga ndonjë formë e presionit nga kush do, z. LASKI u përgjigj jo, vetëm një ditë kur kishte ndodhur një protestë dhe se emri i Astritit ishte përmendur gjatë protestës e kemi parë se lëvizte pa pushim në qeli. Gjatë natës së 04 nëntorit 2016, ai ishte zgjuar dhe e kishte vërejtur Astritin që ishte fjetur me këpuca. Dhjetë minuta më vonë, e dëgjoi Astritin se u zgjua, zbriti nga krevati dhe shkoi në sirtar. Këtë e bëri tri a katër herë. Në një moment i kishte thënë të shtrihet për të fjetur. Pastaj ai i hoqi këpucët dhe u shtri për të fjetur rreth orës 2 ose 3 të mëngjesit.

**PV e audiencës së z. GASHI Adonis i 05 nëntorit 2016 – i mbajtur në të njëjtën qeli me z. DEHARI Astrit.**

Z. GASHI ishte në të njëjtën qeli me z. DEHARI Astrit që një javë e gjysmë. Sipas tij z. DEHARI ishte një tip i mbyllur, fjalëpakë, shumë i qetë, që asnjëherë nuk ka treguar shenja që shprehnin vullnetin për të bërë keq. Pas kthimit nga shëtitja, rreth orës 15:00 e ka parë Astritin të shtrirë mbi tokë në qeli. Pjesa e djathtë e qafës së tij ishte e skuqur dhe ishte i lagur në nivelin e organeve gjenitale. Ai nuk ka vërejtur pranë trupit të tij asnjë objekt me të cilin mund të shkaktoheshin plagë, as gjak në vendin e ngjarjes. Ai e dinte se Astriti ishte një aktivist politik (grupi politik LVV). Ai nuk ankohe për asgjë (ang. "he did not complain of anything").

**PV e audiencës së z. GASHI Adonis i 10 nëntorit 2016 – i mbajtur në të njëjtën qeli me z. DEHARI Astrit.**

Z. GASHI deklaroi se kur ai është kthyer në qeli pas shëtitjes, e ka parë Astritin mbi tokë, kokën e ngritur pak lartë e duart e larguara përgjysmë. Ai konstaton se kishte një plagë në nivelin e qafës, në anën e djathtë. Në mes tjerash, pohon se ai ishte i lagur në pjesët gjenitale dhe se kishte një erë të pakëndshme. Qelia ishte e çrregulluar, me sirtar të hapur, një peshqir i gjelbër mbi tokë si disa nga fletoret e tyre [shënim i ekspertëve: për z. GASHI]. Posa e ka parë Astritin në këtë situatë, ai e ka thirrë gardianin i cili ka mbërritur për disa sekonda dhe e ka larguar shishen e mjaltit nga goja e Astritit. Kur e ka bërë këtë gjest, trupi i Astritit ka lëvizur. Në këtë kohë, teknika medicinale ka mbërritur në qeli dhe ka urdhëruar ta shijnë në infermieri, çfarë edhe kanë bërë të mbajturit. Këmisha e Astritit është hequr dhe ai pohon se gjoksi i tij ishte i kuq. Sirtari i tij gjendje mbi tokë dhe ai konstaton se efektet personale ishin aty. Z. GASHI tregon se ai vetë e kishte blerë kavanozin e mjaltit javën e ardhjes së tij në qeli pasi që ishte me grip. E kishte konsumuar rreth 30%. Sjellja e Astritit ishte e mirë, si me të burgosurit ashtu edhe me gardianët. Gjatë kohës së tij të lirë, ai lexonte libra, shkruante çdo mbrëmje, luante letra dhe shpesh këndonte.

Më 05 nëntor 2016, Astriti ishte mirë, sikur çdo ditë tjetër. Ai e kishte pastruar tualetin dhe z. GASHI i kujtohet shumë mirë se Astriti kishte kënduar një kohë të gjatë nën dush. Asgjë të veçantë nuk kishte hetuar tek ai. Astriti ishte gjallë kur ka dalë ai nga qelia. Ai ishte vetëm në tokë bënte diçka por Gashi nuk e vërejtë se çka. Kur u nxor shishja nga goja e tij, kishte gjak në

gojën e tij. Z. Gashi nuk mendon se dikush tjetër e ka mbytur, duke parë se siguria është shumë e latredhë se askush nuk mund ta bënte këtë. Ai është i bindur se ka bërë vetëvrasje.

**PV e audiencës së z. KASTRATI Daut – gardian i burgut – më 05 nëntorit 2016**

Z. KASTRATI ishte i caktuar në krahu A – 7/19 nga ora 07:00 deri në 19:00. Në ora 14 ai ka shkruar në qeli A3 për shëtitjen e pasdites. Kur e hapi derën, z. DEHARI i kërkoi nëse mund të qëndrojë në qeli sepse dëshironte ta rregullonte dhe se kishte pak ftohtë.

Në ora 15:05, të mbajturit e krahu A u kthyen nga shëtitje. Të bashkë mbajturit e z. DEHARI vetë e tre të mbajtur tjerë kanë "reaguar" dhe kanë kërkuar ndihmë. Z. KASTRATI i ka dhënë ndihmën e parë duke e hequr shishen e plastikës rreth 5 cm nga goja e tij. Pasi që e ka heq shishen, ai ka konstatuar se z. DEHARI kishte ende puls. Pastaj ndihmësit kanë ardhur në qeli.

**PV e audiencës së z. KASTRATI Daut – gardian i burgut – më 05 nëntorit 2016**

Z. KASTRATI raporton se më 05 nëntor 2016, ai ia ka dhënë një brisk rroje z. DEHARI dhe se ky i fundit e ka kthyer në vendin e zakonshëm pasi që është rruar. Z. KASTRATI saktëson se z. DEHARI nuk kishte probleme me të mbajturit tjerë, si dhe me askënd aty. Sjellja e tij ishte shumë e mirë. Ai ishte shumë i edukuar dhe i sjellshëm me të gjithë. Z. KASTRATI mendon se stilolapsi i lidhur me lidhësen e këpucëve, i gjetur në tualet, ishte përdorur për të mbyllur derën e tualetit e cila nganjëherë nuk mbyllet mirë. Kur të mbajturit tjerë janë kthyer nga shëtitja, z. DEHARI ishte gjallë, në qelinë e tij vetëm. Një tjetër i mbajtur nuk ka dalë në shëtitje atë ditë, z. MAZREKU Istref, i qelisë A2. Pasi që e ka tërhequr shishen e plastikës nga goja e z. DEHARI, ai ka konstatuar se goja e tij lëvizte dhe se ajri dilte nga goja e tij. Sipas z. KASTRATI, shishja ishte futur në gojë nga fundi i shishes (ang. "from the botton of the bottle"). Ai pohon se nuk i kujtohet se ka pasur gjak në qeli.

**PV e audiencës së z. MAZREKU Istref i 09 nëntorit 2016 – i mbajtur në qelinë A2 të qendrës së paraburgimit.**

Z. MAZREKU mbahej në qelinë A2 dhe gjendej në qeli gjatë kohës së shëtitjes pasi që nuk ndihej mirë. Gjatë kësaj kohe, ai gjendej vetëm në qelinë e tij, gjysmë i fjetur. Por pas përfundimit të shëtitjes rreth 10 minuta më herët pasi që të tjerët të kthehen, ai ka dëgjuar dy apo tri zhurma të lehta, pa mundur të tregojë se prej nga vinin këto zhurma.

**PV e audiencës së z. ALLAKAJ Luz i 10 nëntorit 2016 – i mbajtur në qelinë A6 të qendrës së paraburgimit.**

Në momentin ardhjes nga qelitet, z. ALLAKAJ mbahej në qelinë A6. Ai shpjegon se të gjithë ishin grumbulluar tek dera e qelisë së Astritit dhe se ai e ka parë Astritin shtrirë në shpinë, duart

# ASTIN E VDEKJES SË ASTRIT DEHARIT

e hapura me një shishe mjalti në gojë. Shishja ishte futur shumë thellë në gojën e tij (më shumë se gjysma dhe ndër tjera ai ka vërejtur një cikatrice në anën e djathtë të qafës. Ai ishte i lagur tek organet gjenitale. Ai u ka ndihmuar për ta bartur trupin e Astritit në infirmieri. Ai nuk di të thotë se a ishte gjallë në këtë moment. Ai ishte pak i errët (angl. "blackened"). Z. ALLAKAJ mendon se Astriti e ka bërë vetë tërë këtë.

**PV e audiencës së z. BAJRAMI Almir i 13 nëntorit 2016 – teknik mjekësor në qendrën e parburgimit.**

Z. BAJRAMI është teknik i mjekësisë. Më 05 nëntor 2016, rreth orës 15:05, ata kanë pranuar një thirrje nga qendra e parburgimit me informimin se dikush kishte vdekur në qendër. Ekipi i tij ishte drejtohej nga Dr SINANI Fisnik. Në momentin e mbërritjes së tyre, trupi ishte i shtrirë mbi një krevat, mjeku ishte i pari që iu afrua dhe ai u kërkoi që ta vendosin trupin mbi tokë. Menjëherë pas kësaj, një akçes venoz u vendos në vend. Një kolegë e përgatiti adrenalinën. Mjeku urdhëroi të fillohet rianimacioni dhe u fillua me një intubacion. Gjatë rianimit, z. DEHARI ka nxjerrë ujë nga goja i cili është thithur nga ndihmësit. Ata rifilluan me rianimim dhe pas një kohe, mjeku ka urdhëruar të vendoset trupi mbi një barelë dhe të transportohet në spital.

Me të arritur në vendin e caktuar, mjeku e vendosi një pulsoksimetër mbi gishtin e pacientit pastaj e verifikoi bebëzat, pulsën dhe urdhëroi të vendoset mbi tokë dhe të rianimohet. Z. BAJRAMI shpjegon se teknikët nuk janë në gjendje të thonë se pacienti paraqiste shenja jete dhe pyetja tu shtrihet kjo pyetje mjekëve.

**PV e audiencës së zonj. KODRALIU Bukurie 09 nëntorit 2016 – infermiere në qendrën e parburgimit.**

Zonj. KODRALIU është infermiere në qendrën e parburgimit në Prizren, puna e saj përqendrohet në ofrimin e trajtimeve mjekësore për të mbajturit. Ajo është thirrur më 05 nëntor 2016 në ora 15:00. Kur ka mbërrit në qelminë A3 ajo e ka parë Astritin të shtrirë mbi tokë, kokën e kthyer pak në të majtë, këmbët afër derës së tualetit dhe duart e larguara. Kishte të vjella pranë tij. Ajo e ka verifikuar pulsën e tij në qafë dhe ka konstatuar se ai kishte pulse dhe se merrte frymë. Pastaj, ajo ka thirrë ndihmën dhe i ka kërkuar ekipit ta transferojnë të burgosurin poshtë drejt ambulancës. Të burgosurit e kanë bartur Astritin drejt ambulancës, ku ajo ka filluar t'ia jep ndihmën e nevojshme. Në nivelin e qafës kishte një vijë shumë të hollë dhe pak gjak, sikur kur dikush pritët duke u rruar. Ai kishte një prerje të vogël në nivelin e dorës e cila mezi shihej. Ai ishte shumë i zbehtë.

**PV e audiencës së Dr. SINANI Fisnik i 13 nëntorit 2016 – mjek**

Dr. SINANI deklaroi se tekniku mjekësor, z. BAJRAMI ka pranuar një thirrje telefonike nga qendra e parburgimit në Prizren se një vetë vrasje kishte ndodhur dhe se një ambulancë ishte e nevojshme. Me të mbërritur në qendrën e parburgimit në ora 15:00, personi ishte i shtrirë mbi një krevat. Ai ishte cianotik. Bebëzat ishin të zgjeruara. Ai nuk kishte puls periferik sipas informatave të oksimetrit. Ai nuk kishte as puls qendror. Dr. SINANI ka kërkuar lëndime mbi trupin e tij, në dritën e informacioneve të marrë që referonin për vetëvrasje. Në nivelin e kyçit të majtë (ang. "on the left hand, dhe bracolët part") [shënime të ekspertëve: që ne e interpretojmë si kyç], kishte një prerje të thatë sipërfaqësore. Një plagë sigurisht që ishte e pranishme në nivelin e pjesës së djathtë të qafës, në formë të gërvishjes me gjak të tharë. Dr. SINANI ka filluar reanimimin dhe i ka kërkuar Almirin të vendos një tub venoze për të injektuar solucion të NaCl. Gjatë reanimimit, z. DEHARI villoi në vazhdimësi. Gjithnjë nuk kishte shenjë të pulsit në oksimetër. Ai ka bërë një injeksion të parë pastaj të dytën me adrenalinë. Ai e ka thithur pacientin në gojë dhe e ka intubuar për arsyet e cekura më lartë. Në rast se ai nuk kishet shenja jete, si një puls apo një respirim, ai ka vendosur ta transferojë z. DEHARI në spital.

**PV e audiencës së z. ABDULLAHU Fadil 13 nëntorit 2016 – teknik medicinal.**

Z. ABDULLAHU deklaroi se ka pranuar një thirrje nga qendra e parburgimit rreth orës 15:05 për shkak të një vetëvrasjeje. Dr. Fisnik, Almir dhe një vullnetar Enis menjëherë kanë mbërrit në infirmieri të qendrës së parburgimit ata kanë mbërrit rreth orës 15:08. Mjeku ka vendosur oksimetrin dhe ka konstatuar se nuk kishte shenja jete. Sipas udhëzimeve të mjekut z. ABDULLAHU i ka dhënë një dozë të parë adrenaline pastaj aminofilin (2x përgjysmë: bronkodilator) dhe prapë adrenalinë. Rianimimi ka vazhduar për disa minuta por pacienti nuk tregonte asnjë shenjë jete sipas mjekut. Ai kishte të prera me gjak në nivelin e kyçit dhe në anën e djathtë të qafës.

**k. Përshkrimi i vendi ku u zbulua trupi**

**Sipas raportit të Njësisë së Forenzikës së policisë të Kosovës të 10 nëntorit 2016:**

Qelia A3 gjendet në katin e dytë të qendrës së parburgimit në krahun A. Në qeli gjendet një banjë.

Mbi dyshemenë e qelisë, gjenden (ndër të tjera) këto elemente: gjurmët e evokuara të gjakut, një kosh i mbeturinave, një sfunjër i mbështjellë me një këmishë(majicë) të zezë ( e cila ishte përdorur si një pashqir, e lagur me një materie e cila mund të ishte jargë ose vjellje), një lidhëse e kaltër, peshqirë, një shishe plastike me gjurmë që evokonin gjak, një shishe, një sapun me gjurmë që evokonin gjak, sytha pambuku, një brisk rroje me gjurmë që evokonin gjak. Të varur për krevati gjendeshin objekte nga najloni që formonin një lloj litari.

Dera e tualetit ishte e hapur. Brenda, mbi tokë gjendej një stilograf që paraqiste gjurmë të kuqe që evokonin gjak, lidhur sigurisht në një lidhëse këpucësh. Në tualet gjendej një lavaman metalik mbi të cilin gjurmë të kuqërremta, që tregonin gjak, ishin të dukshme. Përbrenda lavamanit,

kishte një pjesë metalike që dyshohej se ishte një brisk rroje me gjurmë të kuqërreme që tregonin gjak.

**Sipas listës së provave (ang. "list of evidence") të Njësisë së Forenzikës së policisë së Kosovës, pa datë:**

Në këtë listë, ne kemi vënë re elementët e mëposhtme:

- Një lidhëse këpucësh e kaltër e gjatë rreth 58 cm (#1)
- Një shishe plastike me një kapak të verdhë që përmbante lëng që evokonte mjaltë (#5)
- Një bokall të llojit të çajnikut me mbishkrim "SINBO" me një kabull elektrike e gjatë 90 cm (#6),
- Një sapun (ang."soup" sic [shënim i ekspertëve: sigurisht gabim shtypi, ne e interpretojmë këtë fjalë si "saop" (#7), ngjyrë rozë-kuqe e mbuluar me një ngjyrë kafe që evokonte gjak (#7),
- Një brisk rroje me mbishkrim Gillette me 5 brisqe i mbuluar me gjurmë të kuqe që evokonte gjak (#13),
- Një stilolaps me mbishkrim ECOLAB i lidhur në një lidhës këpucësh me ngjyrë të katër (#14),
- Një objekt metalik që paraqiste një brisk rroje (#17),
- Dy "pjesë" najloni të rregulluara në formë të një litari, më e madhja prej 1 x 85 cm dhe e dyta prej 1 x 36 cm (#18),

**Sipas raportit të Njësisë Forenzike të policisë së Kosovës të 17 nëntorit 2016:**

Më 17 nëntor 2016, reaktivi "BLUESTAR" është përdorur në qelinë A3 të qendrës së parburgimit të Prizrenit me qëllim që të vihen në pah gjurmët e gjakut. Gjurmët e gjakut ishin vënë në pah përbrenda lavamanit (këndi i drejtë), mbi tokë të tualetit (ang. "With" sic) një spagë e lidhur për dere (të banjës) në raftin e majës së dollapit të z. Naser MAKOLLI, mbi raftet e epërme prej plastike, në të kundërtën e tualetit dhe mbi tokë të qelisë ( një pjesë nën krevat).

Me 17 nëntor 2016, fotografi [shënim i ekspertëve: fotografi që nuk janë dorëzuar në procedurë] të bashkëmbajtësve dhe të z. DEHARI janë bërë në dhomën e ambulancës së qendrës së parburgimit të Prizrenit në prani të Bardhyl Shehut (shef i infirmierisë) dhe Elmira Berishës (teknik mjekësor). Kemi të bëjmë me Naser MAKOLLIN (14:05), Frrok LASKUN (14:14) dhe Adonis GASHIN (14:23). Fotografitë janë bërë mbi njerëz lakuriq pa vënë në pah lëndime (ang. "injury"), gjurmë (ang. "trace") ose asnjë shenjë dyshimi (ang. "suspicious sign").

Me 17 nëntor 2016, një bllok shënimesh (ang. "notebook") sigurisht që i përkiste z. DEHARI është gjetur mbi tokë, afër krevatit të Naser MAKOLLIT.

**Raporti i autopsisë së z. DEHARI Astrit i Institutit të mjekësisë ligjore të Kosovës (raporti nr. MA16-286) pa datë.**

Autopsia e z. DEHARI Astrit, i lindur më 26 shkurt 1990, është kryer më 07 nëntor 2016 nga ora 15:05 (shënim i ekspertëve: ora 23 e 10 minuta pas konstatimit të vdekjes) nga tre mjekë ligjor (koronar), që dihen Dr. Musa Gashi, Dr. Naim Haliti dhe Dr. Flutra Blakaj. Gjatë autopsisë, 19 persona tjerë janë listuar si të pranishëm, në veçanti tre ekspertë të rekrutuar nga familja e të ndjerit, Dr. Besim Latifaj (patolog nga Anglia), Dr. Besim Ymaj (mjekë ligjor-Shqipëri) dhe Dr. Hatixhe Latifi (Kosovë).

Raporti i autopsisë përmban një paragraf mbi rrobat e të ndjerit elementët e të cilin ne i kemi shënuar në vijim:

- Trupi barte një xhakë të, këmishë me mangë të gjata, pantallona të ushtrimeve dhe një palë brekë,
- Në pjesën e djathtë të xhakës, gjurmë të kuqe janë vënë në pah, që ngjanin në gjak.

Raporti i autopsisë përmban një paragraf mbi kujdesin mjekësor të të ndjerit ne i kemi konsideruar këto elemente.

- Me të pranuar në spital më 5 nëntor 2019 në ora 15:20, z. DEHARI nuk tregonte shenja jete. Ai ishte i pavetëdijshëm, pa puls, pa shtypje arteriale, me një cianoze të përgjithshme dhe me bebëza të zgjeruara. Ai paraqiste në nivelin lateral cervical të djathtë, gërvishje (ang. "scratches") në formë të zhvoshkjes (ang. "excoriation") të pranishme në veçanti në nivelin e dy nyjave. "R/C" [shënim i ekspertëve: që ne e interpretojmë si që të jenë artikulacione radio-karpale].
- Në ora 15:30, anesteziisti ka gjetur një pacient me pavetëdijë, pa puls, pa tension dhe i intubuar,
- Një rianimim kardio-pulmonar tashmë ishte kryer është vazhduar me masazh kardiak dhe me ventilim. Pacienti ka qenë i defibriluar shumë herë dhe ai ka pranuar adrenalinë, bikarbonat, atropine dhe dopamine. Vdekja është deklaruar në ora 15:55, me diagnozë përfundimtare arrest kardiovaskular dhe vdekja.

Ne i kemi caktuar edhe elementët në vazhdim të ekzaminimit të jashtëm të trupit, të përfshirë në raport:

- Prania e një fashe, e vendosur rreth kokës, ndërmjet pjesës supero të mesme të kokës dhe mjekrës,
- Prania e një kompresë të lyer me gjak, në nivelin e regjionit latero-cervikal të djathtë e mbajtur me ngjitës,
- Prania e një fashe në nivelin e kyçit të majtë,

**Vijon në numrin e ardhshëm**

## Kremlini: Vdekja e Baghdadit fuqizon Trumpin, nëse vërtet ka ndodhur

MOSKË, 28 TETOR - Kremlini ka thënë të hënën se presidenti amerikan Donald Trump ka bërë një kontribut të madh në luftimin e terrorizmit ndërkombëtar, nëse është e vërtetë deklarata se është vrarë Abu Bakr al-Baghdadi, lideri i grupit militant, Shteti Islamik. Trump ka njoftuar të dielën se Baghdadi ka kryer vetëvrasje gjatë bastisjes së forcave speciale amerikane në Siri si dhe ka falënderuar Rusinë, në mesin e vendeve të tjera, për mbështetjen që ua kanë dhënë Shteteve të Bashkuara.

Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, ka mohuar të tregojë të hënën nëse Shtetet e Bashkuara e kanë informuar

paraprakisht Rusinë për këtë operacion. Mirëpo ai u ka thënë gazetarëve se Ushtria ruse ka vërejtur aeroplanët amerikanë dhe dronët në zonën në të cilën Uashingtoni ka thënë se ka kryer operacionin në Siri. "Nëse informacioni për vrasjen e Baghdadit konfirmohet, ne mund të flasim për kontributin serioz të presidentit të Shteteve të Bashkuara në luftimin e terrorizmit ndërkombëtar", ka thënë Peskov.

Ministria ruse e Mbrojtjes ka thënë se ka dilema në deklaratat e Trumpit, pasi aty nuk janë dhënë informacione të besueshme rreth operacionit amerikan, si dhe janë dhënë katër arsye pse versioni i ShBA-

së duket i dyshimtë. "Numri në rritje i pjesëmarrësve në operacion dhe shtetet që dyshohet se kanë qenë pjesë e 'operacionit', secili me detaje kontradiktore, rrit pyetjet dhe dyshimet nëse ka ndodhur dhe sa i suksesshëm ka qenë", ka thënë kjo ministri.

Për dallim nga Kremlini, ministria po ashtu ka ulur rëndësinë e Baghdadit, duke thënë se edhe nëse konfirmohet vdekja e tij, sërish "nuk do të ketë rëndësi operationale" në situatën në Siri apo në veprimet e militantëve të mbetur në rajonin Idlib të Sirisë.

Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka njoftuar të dielën për vrasjen e Al-Baghdadit, në një



sulm të forcave amerikane në fshatin Barisha të provincës Idlib, në veriperëndim të Sirisë. Al-Baghdadi ka qenë një nga terroristët më të kërkuar në botë.

Në kulmin e fuqisë më 2014 dhe 2015, grupi Shteti Islamik ka kontrolluar një sipërfaqe prej 88 000 kilometrash katrorë që shtrihej nga Siria Perëndimore në Irakun Lindor.

# Ushtria amerikane veproi me shpejtësi pas informacioneve të zbulimit

Nënpresidenti Mike Pence tha se Shtetet e Bashkuara kishin të dhëna të sakta se Baghdadi do të gjendej në Idlib të Sirisë dhe morën informacion të mëtejshëm të shtunën në mëngjes që përcaktoi vendimin për ta zhvilluar operacionin gjatë natës



WASHINGTON, 28 TETOR - Sekretari amerikan i Mbrojtjes Mark Esper dhe nënpresidenti Mike Pence thanë se informacionet e zbulimit të minutës së fundit u mundësuan forcave speciale hapësirën e nevojshme për ta zhvilluar sulmin ndaj udhëheqësit të Shtetit Islamik Abu Bakr al-Baghdadi, pasi presidenti Donald Trump dha miratimin këtë javë.

Nënpresidenti Mike Pence i tha kanalit "CBS News" si deri të enjten pasdite, Shtetet e Bashkuara kishin të dhëna të sakta se Baghdadi do të gjendej në Idlib të Sirisë. Ai shtoi se Shtetet e Bashkuara morën informacion të mëtejshëm të shtunën në mëngjes që përcaktoi vendimin për ta zhvilluar operacionin gjatë natës. Një zyrtar amerikan i tha "Zërit të Amerikës" se operacioni u plani-

fikua në një bazë në Irak. Presidenti Trump tha se tetë helikopterë udhëtuan për gati një orë për t'iu afruar objektit ku ndodhej al-Baghdadi.

Sekretari i Mbrojtjes, Esper, tha se ushtarët synonin ta kapnin të gjallë, por se ishin për gatitur edhe për të kundërtën. Njësisia i bëri thirrje al-Baghdadit që të dorëzohet. "Ai refuzoi. U fut në një pjesë të nëndheshme dhe ndërsa filloi përpjekja për ta nxjerrë, mendojmë se ai shpërtheu një jelek vetëvrasës dhe i mori jetën vetes", i tha sekretari Esper kanalit CNN.

Sipas nënpresidentit Pence, opsionet e paraqitur nga ushtarakët u shqyrtuan nga presidenti Trump të premten në mëngjes. "Ai i shqyrtoi, bëri pyetje të shkëlqyera dhe zgjodhi opsionin që menduam se do të na jepte probabilitetin më të lartë për të dalë me sukses, si dhe konfirmimin se kreu i ISIS-it do të ishte vërtet aty dhe që do të kapej apo do të vritej", shtoi sekretari Esper.

Sekretari Esper tha se gjatë operacionit pati dy të plagosur lehtë në radhët e ushtarakëve amerikanë,

por që tashmë janë rikthyer në shërbim. Presidenti Trump gjithashtu bëri me dije se një qen i ushtrisë ishte plagosur.

Mazloum Abdi, komandanti i Forcave Demokratike Siriane që iu bashkuan ShBA-së për ta mposhtur Shtetin Islamik në Siri, falënderoi presidentin Trump në "Twitter" dhe shtoi se gjatë pesë muajve të fundit është monitoruar bashkërisht me ShBA-në dhe janë zhvilluar operacione zbulimi në terren. Ai e quajti vdekjen e Baghdadit një "operacion të përbashkët" si dhe foli për "opera-

cione të tjera efikase" në të ardhmen mes ShBA-së dhe Forcave Demokratike Siriane. Ai më vonë shtoi se një tjetër operacion në rajon siguroi vrasjen e zëdhënësit të Shtetit Islamik, Hassan al-Muhajir. Zyrtarët amerikanë refuzuan t'i komentojnë këto mesazhe të Abdit.

Gjatë njoftimit të tij presidenti Trump falënderoi Forcat Demokratike Siriane, Irakun, Rusinë, Turqinë dhe Sirinë, krahas forcave amerikane, për të cilat tha se u treguan "kaq të guximshme dhe kaq të mira".

## Brexit shtyhet deri më 31 janar

LONDËR, 28 TETOR - Bashkimi Evropian ka rënë dakord ta shtyjë daljen e Britanisë deri më 31 janar vitin e ardhshëm, tha të hënën kreu i BE-së, Donald Tusk.

Tusku tha se "BE-27a ka rënë dakord ta pranojë kërkesën e Britanisë për një zgjatje elastike të Brexitit", që do të thotë se Britania mund të largohet më

herët nëse parlamenti i saj ratifikon projektligjin e ndarjes me BE-në.

Vendimi për një "zgjatje elastike" erdhi pas një takimi 30 minutësh të ambasadorëve të bllokut prej 27 anëtarësh në Bruksel, pasi Franca tërhoqi kundërshtimet e saj që e kishin bllokuar marrjen e një vendimi javën e kaluar. Çdo shtyrje për

shkëputjen e Britanisë mund të pranohet vetëm me votën e njëzëshme të të 27 anëtarëve. Megjithatë, një shtyrje e tretë dhe e fundit e mundshme e shkëputjes do të shoqërohet me kushte, duke përfshirë refuzimin për ta rin negociuar marrëveshjen dhe duke lejuar anëtarët e BE-së të mblidhen pa Britaninë për të diskutuar mbi të ardhmen e bllokut.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**E jashtëzakonshme**

## Vepra e artit e gjetur në kuzhinë thyen rekord në ankand

Një pikturë e humbur e artit të famshëm italian, e gjetur në kuzhinën e një gruaje të moshuar franceze, është shitur në ankand për një çmim rekord 24 milionë euro në ankand. Christ Mocked e piktorit Cimabue u zbulua muajin e kaluar në Francën veriore. Piktura pritej të shitej për 6 milionë euro në ankand, por oferta fituese i tejkaloi shumë pritjet.



**FOTO E DITES**



Dy drerë në Britani shihen duke u përplasur mes vete. /Reuters/

**E rrallë**

## Pajisja e çuditshme bie nga qielli



Nensi Uelke dhe burri i saj, Den, po bëheshin gati të nxirrnin kuajt nga stallat kur dëgjuan një përplasje të fortë në oborr. Çifti nga Miçigani i ShBA-së shkoi të shohin se çfarë e kishte shkaktuar zhurmën dhe gjeti një objekt që dukej si satelit e që vazhdonte të lëshonte një gumëzhimë elektronike. Në të ishte shkruar "Samsung Space Selfie" dhe, sipas kompanisë koreane-jugore, ishte hedhur për të kapur pamje me planetin tonë në sfond.

**BARSOLETA E DITËS**



**Djali:** - Babë, a di se me zënë hajnin t'u vjedhë e me rreh shkon në burg?  
**Baba:** Jo bre, e pse ashtu?  
**Djali:** Sepse hajni, kur hyn për të vjedhur, është në orar të punës!



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Vetem gjatë vikendit në ora 14:00

### ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.  
 Regjia: Jill Culton



Çdo ditë në ora 16:00

### TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.  
 Regjia: Josh Cooley



Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

### MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.  
 Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

### ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Dita e parë e këtij muaji do të nisë me shkrimet që lidhen me krijimin ose projektet që kanë të bëjnë me komunikimin.</p>	 <p><b>DEMI</b> Ju jeni persona që e vlerësoni shumë familjen dhe rrallë mund të mendoni të kundërtën.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Disa libra që ju duken interesantë po ndryshojnë jetën tuaj në disa mënyra.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Zakonisht ju besoni instinktët tuaja për paratë, por sot besoni më shumë logjikën.</p>	 <p><b>LUANI</b> Një mik ose një grup me të cilin qëndroni mund të jetë duke ndryshuar jo vetëm personalitetin tuaj, por edhe jetën.</p>	 <p><b>VIRGJËRËSHA</b> A keni qenë duke menduar që të ndryshoni punë ose të provoni një profesion të ri? Nëse është kështu, sot është dita për ta provuar.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Mund të pësoni një transformim radikal të rutinës së përditshme.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Sot mund të sulmohen vlerat tuaja. Ndoshta një koleg në punë mund të bëjë gjëra që nuk ju duken etike dhe nuk doni të jeni më pranë tyre.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Ditën e sotme do ta kaloni duke u kujdesur me ortakëri, qofshin këto personale apo pune.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Sot do të përqendroheni te hulumtimi në fushat e paqarta të punës suaj.</p>	 <p><b>UJORI</b> Do të keni një ditë fantastike. Ju do të kryeni çdo detyrë që ju kërkohet dhe jeta në çift sot do të jetë shumë e zjarrtë.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Disa punë që lidhen me infra-strukturën e shtëpisë suaj duhet të përfundohen sot.</p>


## Jamesi dhe Lisa martohen fshehurazi



**J**ames McAvoy dhe Lisa Liberati thuhet se janë martuar. Aktori 40-vjeçar dhe aktorja në të njëjtën moshë u kurorëzuan fshehurazi, tha një mik i tyre për "Daily Mail". Çifti nisi lidhjen në vitin 2017

pasi u takuan në një set filmi. Jamesi më parë ishte i martuar me Anne-Marie Duff me të cilën u nda pas 11 vjet martesë. Dy muaj pasi përfundoi divorci, James dhe Lisa e kanë bërë publike romancën e tyre.

## Kanye West: Do të jem president i ShBA-së



**R**eperi i njohur, Kanye West, ende mendon se në të ardhmen mund të jetë president i ShBA-së. Në një intervistë të fundit artisti tha se do të hyjë në garë për Shtëpinë e Bardhë në vitin 2024, madje është i sigurt se do të

fitojë. "Do të vijë një ditë që unë do të jem president i ShBA-së", ka thënë ai. Babai i katër fëmijëve, që duket se e ka më shumë se seriozisht kandidimin për president, tha se është në mënyrë absolute "artisti më i madh i të gjitha kohëve".



## Nëna e Lady Gagas tregon për depresionin e vajzës së saj

**K**ëngëtarja e famshme Lady Gaga është përfolur shumë për shëndetin mendor. Në fillimin e betejës së saj me ankthin dhe depresionin ajo ishte thjesht një fëmijë i zakonshëm që kishte nevojë për nënën e vet. "Si prind nuk isha e gatshme ta përballoja këtë. Ajo kaloi kohë të vështira, e poshtëruar, përhumbur, e izoluar. Nga një vajzë e re e lumtur dhe

frymëzuese u shndërrua në dikë që filloi të vinte në dyshim vlerësimin për veten", ka deklaruar nëna e Gagas, Cynthia Germanotta, për programin televiziv CBS This Morning. Në vitin 2012 këngëtarja së bashku me të ëmën bashkë themeluan fondacionin "Born This Way" që ua jep mundësinë të rinjve ta praktikojnë shëndetin mendor dhe emocional.

## Mel B nis një lidhje të re



**R**aportohet se Mel B është në lidhje me frizerin e vet Rory McPhee. Sipas burimeve, artistja e Spice Girls është shumë e lumtur për lidhjen e re. Çifti është parë edhe publikisht, në një

dasmë të një miku. Sipas një burimi të "The Sun", Mel është e lumtur me lidhjen e re. "Në dasmë ata janë parë shumë të buzëqeshur pranë njëri-tjetrit", ka thënë ky burim.

# MBI DISA ÇËSHTJE TË TRADITËS SË SHKRIMIT DHE TË DREJTSHKRIMIT TË SHQIPES (2)

**Nga: Eqrem ÇABEJ**  
(fjalimi i mbajtur në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972)

Një nga parimet që kanë rezultuar të jenë të drejta në këtë fushë është marrja parasysh e kriterit të shtrirjes teritoriale të dukurive në caktim të normave drejtshkrimore. Konkretisht, kur një formë e caktuar përdoret në mbarë trevën e njërit nga dialektet kryesore dhe pjesërisht edhe në tjetrin, ajo me të drejtë ngrihet në normë të shkrimit. Në bazë të këtij kriteri përdoret vend edhe zemër, jo vënd edhe zëmër. Për të njëjtën arsye të konvergencës ka zënë vend edhe shkrimi i bashkëtingëlloreve fundore të zëshme si të tilla, me gjithë shqiptimin e pazëshëm të tyre në një pjesë të mirë të dialekteve jugore, shkrim që pajton dhe me ruajtjen e strukturës morfologjike të fjalëve përkatëse, në rasi si shtogu, i madhi, mblodha. Për të njëjtin kriter është arritur, ndër të tjera, përdorimi i j-së në vend të nazalit palatal nj në fund (e në trup) fjale te foljet, tipi punoj, punoja, dhe po për këtë arsye janë gjithë mundësitë që ky përdorim të shtrihet edhe në sistemin nominal, tipi ullinj, të mëdhenj, forma që s'janë të huaja as për ligjërimet jugore. Parimi i thjeshtimit drejtshkrimor është zbatuar në dobi sidomos

në përdorim të ë-së së pathekse, një nga pikat, sikundër dihet, kryesore të drejtshkrimit të shqipes. Duke i dalë përpara prirjes së dukshme të gjuhës për një thjeshtim më të madh në punë të shkrimit të këtij vokali në të ardhmen, mund të shkohet më tej në këtë drejtim, duke shkruar ndër të tjera amtar, pishtar, arsim, kshill, pjestar, pjestim, përmendsh, trekëndsh, trajta fjalësh që gjinden pjesërisht që në traditën e vjetër të shkrimit (si kshill), e pjesërisht në mbarë truallin e sotëm të gjuhës. Aty duhet të hyjnë dhe shumësit dit dhe net. Shkrimi i tyre me një ë fundore, në kundërshtim me mbarë përdorimin gojor dhe me mbarë traditën letrare, nuk përlligjet shkencërisht me trajtat e shquara, ditët, netët, sa kohë që ka edhe rasi të përkundërta, si lot përkundrejt lotët, të zot përkundrejt të zotët, njëzet përkundrejt të njëzetët. Edhe të lidhoret e tipit të dalësh, të marrësh do parë mirë gjer ku kriteri i përpjestimit të përhapjes teritoriale lejon këto shkrime me ë të rrokjes fundore. Nga ky kriter, dhe nga parimi i konvergencës e përgjithësisht nga arsyeja e shëndoshë, duhej të udhëhiqej drejtshkrimi dhe në shkrim të formave Mitkoja, Pirroja, apo Mitkua, Pirrua. Format e llojit të parë imponohen aq më shumë, kur të mendohet se ku do të çonin trajtat e shquara të fjalëve dhe emrave si kakao, foto, Romeo, radio, studio, trio, Klio,

sikur të zbatoheshin mënyrat krahinore me ua për mbarë fushën gjuhësore të shqipes. Nuk do të rimerren këtu grupet zanore ie, ye dhe grupet bashkëtingëllore mb, nd, ngj, që u zunë ngoje më lart, ku norma drejtshkrimore është arritur prej kohësh. As variantet tashmë marginale të tipit motrë, veglë, dorzë, ku në shkrim janë arritur gjithashtu format e përbashkëta që dihen. Vetëm do të preket, si një rasë tipike e konvergencës, depërtimi i sufiksit të agentit -ues (dërgues, mësues, sulmues) në gjuhën e përbashkët të shkrimit, i cili po fiton edhe mbi variantin popullor përgjegjës -uas të Jugut (liruas, përçuas, përgjuas, shpëtuas) edhe mbi -onjës, që në ligjërimet veriake paraqitet si -ojs, -ojse, në fjalë si diftojs, mësojs, fërkojse. Depërtimi ndër dialektor vërehet në fjalëformim edhe në të tjera formante. Hyjnë aty sufikset -ueshëm e -yeshëm, në rasi si i besueshëm, i gëzueshëm, i rrëmbyeshëm. Pastaj sufiksi -meni i Shqipërisë së mesme, në fjalë popullore si pameni "pamje, panoramë", i cili me funksionin më fort të mundësisë, me trajtën e tij të kryehershme dhe me trajtën përgjegjëse të ndërtuar -mëri, u bë produktiv në gjuhë, në rasi si gatishmëri, ngjashmëri. Përtej caqeve të formës, edhe në fushën kuptimore të fjalëve ka shpërngulje drejt konvergencës, me integrim të domethëniesive dialektore në

domethënie më të përgjithshme, më përfshirëse, si për shembëll te çoj, sot kryesisht "shpie, përcjell, dërgoj, nis; ngrë, zgjoj nga gjumi; kaloj kohën, shkoj jetën".


Një kapitull me rëndësi përbën dukuria e univërbimit (një-fjalëzimit), dhe lidhur me të çështja e shkrimit të fjalëve bashkë ose ndaras. Në vjetët e fundit vihet re një prirje për të shkruar si një fjalë të vetme lokucione ndajfoljore e lidhëzore si megjithatë, megjithëse, kurse shkruhet dy fjalë sinonimi i kësaj edhe pse, dhe rekomandohet - a me të drejtë? - një shkrim tri fjalësh për mes për mes etj. Historia e shqipes tregon me të vërtetë prirjen - të shpeshtë në gjuhët më të ndryshme - për të shkrirë në një fjalë sidomos elementet leksikore me një vëllim përgjithësisht të pakët e me pavarësi relative, si pjesëzat a lidhëzat as (bashkë me kompozitet e saj si askurrë, askush, aspak), dot, ndiç, ndonëse, nëse, etj., të cilat për një pjesë të mirë janë formuar nga një fjali a një pjesë fjalie përbrenda sandhit, ngërthimit të fjalisë. Kështu sot shkruhen prej kohësh një fjalë ndër të tjera gjithkush, gjithqish, mbasandej, njëmbëdhjetë, dyqind, pesëdhjetë, ndërkaq, mbassi, vetëvetëhe, të cilat tek autorët e vjetër paraqiten të shkruara me pjesët veç e veç. Tendenca e univërbimit dhe me të e formimit të kompoziteve vihet re dhe në fjalët e reja, si te vajguri nga vaj-guri, në fushën dialektore për shembëll te vetjotja e Siqelisë, në Shqipëri vetja jote. Në lidhje me shkrimin e fjalëve bashkë apo ndaras shtrohet një çështje teorike e karakterit parimor. A janë, dhe a ndihen, megjithatë, megjithëse e të tjera si këto një fjalë e vetme, apo një lidhje fjalësh? Për të sqaruar këtë çështje, po marrim kombinimin e shqipes me mend me kuptim mbiemëror, në shprehje si burrë me mend, e cila i përgjigjet kryekrejt greq. së re me gnosi e me frónisin dhe rum. cuminte, që kanë të njëjtin kuptim. Ndërsa këto lidhje në greqishten e re shkruhen dy fjalë të ndara, ashtu si shkruhet me mend në gjuhën shqipe, rum. cuminte shkruhet sot një fjalë. Kjo tregon se në atë gjuhë



cuminte ndihet si një fjalë e vetme, në shqipen e në greqishten si një lidhje dy fjalësh. Nuk bashkohem me gjykimin e E. Coseriu, i cili në kundërshtim me Kr. Sandfeldin mendon se në formim të rum. cuminte, si një mbiemër i mirëfilltë përkundrejt formave të greqishtes, paska shërbyer si gjedhe, si model, greq. e vjetër echephron "i mençëm, i arsyeshëm". Në pajtim me dijetarin danez mendoj se kemi të bëjmë me një shprehje ballkanike të zakonshme, me kombinimin e parafjalës me + emër në vend të një mbiemri. Shkrimi i shqipes me mend e i rum. cuminte është në fund të fundit një çështje ortografike, e cila lidhet ndërkaq me një konceptim të ndryshëm të fjalës në këto dy gjuhë, më saktë në vetëdijen gjuhësore të bartësve të tyre. Për të dhënë një tjetër shembëll nga kjo kategori e fjalëformimit, mund të përmendet që lidhje të tilla si po ai, po ashtu, jepen në shkrim si dy fjalë të veçanta. Shtrohet pyetja nëse kemi të bëjmë aty me një lidhje dy fjalësh, apo përkundraz me një fjalë të vetme ku po ka një kuptim të vetin, të ndryshëm nga vlerat semantike që ka kjo pjesëz në të tjera sfera të leksikut të gjuhës. Në zgjidhjen e çështjes së shkrimit të fjalëve bashkë ose ndaras mund të ndihmojnë dhe rezultatet e fonetikës eksperimentale. Aty nga mungesa ose prania ose nga përmasat e pauzave që realizohen në shqiptim të këtyre madhësive shumëngjyrëshe, mund të







shihet gjer diku a kemi të bëjmë me një leksemë të mirëfilltë apo me dy a më shumë fjalë a fjalëza të bashkuara në një lidhje leksikore.

Pa dashur të preket parimi që të shkohet brenda mundësive sa më shumë drejt trajtave të vetme, unike të fjalëve, drejt mënjanimi sa më të madh të dubletave në shkrim, mendojmë megjithatë që drejtshkrimi nuk duhet të bëhet tepër i ngrirë, nuk duhet të çojë në ekstrem këtë parim. Kështu mbetet e drejtë rregulla e përdorimit të kallzores së shquar të re, analogjike, të mashkullorët që mbarojnë me zanore të theksuar, tipi kaun, dheun; pa u cënuar kjo rregull ndërkaq, kuptohet vetiut që në disa shprehje të ngulëta të gjuhës popullore, si në fjala mori dhenë, trajta rasore e vjetra do të ruhet, dhe kjo jo vetëm në ligjërimin e folur. Më pak kategorik duhet të dëftohet drejtshkrimi edhe në kufizimin e madh të përdorimit të apostrofit. Disa të dhëna si matanë, mbanë, mënjane, njady, nesër tregojnë qartë sa shpesh elidohet ë-ja e pathekse në ngërthim të fjalisë, në sandhi, gjë që çon në përfitim kompozitash si këto që sapo u përmendën. Për hir të ritmit të fjalisë, me qëllim që të ruhet më i zhdërvjelltë, më i lëvizshëm, më pak monoton ky ritëm, nuk kuptohet pse të mos zbatohet nganjëherë edhe në shkrim eliminimi i ë-së së pathekse fundore, i cili shpeshherë është i plotë në shkrim, e të shënohet ky eliminim me anë të

një apostrofi. Me këtë rrugë thuhet monotonia aty ku kujtohet të ruhet një rregullsi që në thelb është tepër formale e skematike. Edhe në gjuhë të tjera përdoret apostrofi për hir të variacionit ritmik, për një efekt më drastik të shprehjes, si për shembëll në italishten che cos'è, vent'anni, s'agita etj. Lidhur me theksin, edhe aty përjashtimi total nga përdorimi nuk duket të jetë i arsyetuar sa duhet. Pranë rregullave ka edhe përjashtime aty ku e lyp nevoja, edhe këto duhet të gjenin shprehjen e tyre në shkrim. Pikësëpari shtrohet çështja e riprodhimit besnik të një teksti që përmban theksa të ndryshëm, si për shembull e ndonjë poezie të Mjedës. Ka pastaj rasa ku paraqitet nevoja e një theksi për të dalluar leksema të ndryshme, të cilat mund të ngatërroheshin midis tyre, si acari : acari, drejtori : drejtori, format : formát, vëllazëri : vëllazëri, mulla: mullá. Me këtë nuk është e thënë që në të tilla forma fjalësh theksi të jetë përherë i detyrueshëm, shumë herë konteksti tregon qartë se me cilën nga këto kemi të bëjmë. Po në rasat ku mund të lindë një dykuptim, një ambiguitet, aty paraqitet nganjëherë nevoja e theksimit.

Tepër e ngurtë, rigide, e shtrëngueshme paraqitet edhe rregulla që emrat vetiake të burimit të huaj të shkruhen sipas shqiptimit në gjuhët përkatëse dhe në përshtatje me traditën e krijuar në gjuhën shqipe. Të paktën në shkrimet e

karakterit shkencor mund të zbatohet shkrimi sipas formës origjinale të këtyre emrave në ato gjuhë, kjo aq më fort kur riprodhimi i tyre me mjetet e alfabetit të shqipes shpeshherë mbetet i pasaktë e i përafërishëm.

Këto do të ishin disa nga pikat që kanë lidhje me anën formale- fonetike e thjesht gramatikore të drejtshkrimit. Edhe kur të kenë gjetur zgjidhje shumica e çështjeve të kësaj fushe, puna e drejtshkrimit ndërkaq nuk ka mbaruar. Nuk jemi në mbarim, po jemi ende në mes të rrugës, po ta vështrijmë drejtshkrimin me një pamje më të hapët, më tërësore; po ta zgjerojmë tematikën e tij, duke përfshirë në lëmin e vështrimit, sikundër duhet, edhe disa probleme të sintaksës, të frazeologjisë e të leksikut.

Shkrimi i shqipes moderne, në krahasim me atë të periodave të mëparme të saj, karakterizohet për dy tipare kryesore: më një anë për një normim përherë e më të madh të trajtave fonetike e gramatikore të fjalëve dhe për një pasurim progresiv të leksikut me elemente pozitive të vendit; më anë tjetër për depërtimin e ngulitjen e disa ndërtimeve të huaja dhe të një shumice, sa vete më të madh, fjalësh të importuara së jashtmi.

Në lidhje me këtë, në drejtshkrimin të themi sintaktik, në vend të parë duhet synuar në një ndërtim fjalish sipas frymës së shqipes, në harmoni me parimet që zotërojnë në sintak-

sën e kësaj gjuhe, e jo në imitim të ndërtimit sintaktik të gjuhëve të tjera. Duhet nisur së brendshmi, e jo së jashtmi. Me rëndësi është çështja nëse një fjalë do të shkruhet me e apo me ë, me i apo me j, me j apo nj fundore, po ka rëndësi që fjalia të jetë e ndër-tuar pas ndërtimit vetiak të shqipes, jo të njëjës a tjetrës gjuhë të huaj. Ndërtime të tilla si rregullat fonetike dhe ato morfologjike, letërsia artistike dhe ajo popullore, e të tjera si këto, janë të huaja për gjuhën shqipe. Në përdorim të një shtrese të caktuar intelektualësh, po jo në ligjërimin popullor, ato janë italianizma sintaktike, përkthime të ndërtimit sintaktik të italishtes. Të tilla ndërtime ndeshen edhe në rumanishten moderne të shkrimit, edhe aty pas gjedhesh (modelesh) të gjuhëve romane perëndimore, veçse atje janë më të kuptueshme, ngaqë hyjnë në sistemin e një gjuhe gjithashtu romane. Imitim është ndër të tjera edhe përdorimi i lidhëzës pse në fjali shkakore (më fort pas it. perchè), aty ku në shqipen e mirëfilltë përdoret se ose sepse. Në punë të drejtshkrimit nuk janë pa rëndësi dhe shenjat e pikësimit, të cilat peshojnë edhe në përcaktimin e drejtë të kuptimit të fjalëve e të lidhjeve të tyre. Edhe aty gjuha shqipe ka rregullat e veta, të cilat nuk duan lënë mënjane. Vendosi e një prese para lidhëzës në fjali të tipit mendoj, se; është e qartë, që; ka depërtuar në këto vjetër e fundit nga rusishtja, e cila nga ana e saj e ka marrë këtë përdorim prej

gjermanishtes.

Edhe frazeologjia në drejtshkrim nuk duhet lënë pas dore. Kështu, për të dhënë një shembull, shprehjes (i hedh) pluhur syve, e cila nuk është veçse shqipërim i një shprehjeje të gjuhëve të huaja, nga frazeologjia shqiptare i përgjigjet mirëfilli hi syve. Si kjo ka plot shprehje frazeologjike e të thëna popullore, të cilat duhet të shtriheshin në përdorim nga ata që shkruajnë.

Me rëndësi të dorës së parë është më në fund puna e përdorimit të visarit të fjalëve. Aty shtrohet detyra dyfishe e pasurimit dhe e pastrimit. Pasurim me leksema të gjuhës popullore ose gjithësi të farkuara prej brumit të saj. Pastrim nga elementet e huaja që po vërshojnë në gjuhë prej të gjitha anëve. Neologjizmat që janë formuar gjatë historisë së gjuhës me anë përkthimi prej gjuhëve të tjera, si populloret e diel, e hënë, peshkaqen, mol-latartë, vajgur-i, ose përndjek "persekutoj" të Pjetër Budi, hapësirë, vetëdije, ndërgegje e të tjera në shekullin e kaluar, botoj e shkrimtar pak më vonë, botëkuptim, hekurudhë, larg-pamës, mbinjerëzor, ndërldhje, pararajë, përballoj, përvetësoj, i pranishëm, prapavijë, rilindje e të tjera në ditët tona, përbëjnë një pasurim pozitiv të gjuhës; aty gjedhja e formimit është e huaj, lënda është e vendit. Në këtë radhë mund të vazhdohet e të shkohet përpara, duke pastruar e duke pasuruar; duke zvendësuar ndër të tjera fenomen me dukuri, efekt me duk, përkutim me përndjekje, krijoj me lentoj, tekstile me veglore, fjalë shumica të gjalla edhe sot nëpër dialekte. Gjuhëtarëve u bie barra, e gjatë dhe jo e lehtë, që me një punë shumëvjetëshe e të vijueshme të mbledhim visarin leksikor të gjuhës popullore. Të tjerëve, në radhë të parë shkrimtarëve, përkthyesve, arsimtarëve e teknikëve të ndryshëm, u bie ta shtien në qarkullim në botimet e tyre. Mbledhja e këtij materiali është një punë që s'pret, që nuk duron afate. Me industrializimin e vendit, gjuha, duke u modernizuar, bjerr në mënyrë të pazvëndësueshme vazhdimisht një pjesë të elementeve të leksikut të saj. Kjo detyrë duhet të ndërmerret me një plan pune të caktuar mirë edhe të kryhet në mënyrë sistematike.

Duke rrokur me një vështrim përmbledhës detyrat që duhet të përballojë në të ardhmen drejtshkrimi i shqipes i shikuar në aspektet e tij të shumëllojshme, do të përfundohet me këtë, që hartuesit e tij do të udhëhiqen nga një ndjenjë e lartë përgjegjësie. Në formulim të çdo rregulle do të jetë e pranishme vetëdija që është puna për një drejtshkrim të caktuar jo për një disa mijë veta, po për katër milion njerëz që e kanë shqipen gjuhë amtare. (FUND)



SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

# Klubet nuk e harrojnë zanatin e ndërrimit të trajnerëve

Klubet e futbollit në Kosovës duket se nuk e kanë ndërmend të heqin dorë nga ndryshimi i shpeshtë i trajnerëve dhe të punojnë me plane afatgjata. Në dymbëdhjetë xhirot e para janë ndryshuar gjashtë trajnerë, kurse në javët vijuese pritet që ky trend të vazhdojë edhe nga klubet e tjera. I fundit që ka ndryshuar klub është Xhengis Rexhepi, i cili është zëvendësuar nga klubi i Dukagjinit me Severin Elezaj

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 28 TETOR - Trajneri Xhengis Rexhepi pas javës së 12 në IPKO Superligën e Kosovës në futboll vendosi të japë dorëheqje për shkak të rezultateve të dobëta me skuadrën e Dukagjinit nga Klina. Trajneri Rexhepi në njoftimin e dorëheqjes bëri me dije se rezultatet e dobëta e shtynë që të dorëhiqet, kurse ka shtuar se janë munduar që me dinjitet t'i mbrojnë ngjyrat e klubit. "Pas rezultateve negative në drejtimin e KF Dukagjini ndiej përgjegjësi morale të jap dorëheqje. Me dinjitet dhe karakter jemi munduar t'i mbrojmë ngjyrat e klubit. Në pjesën dërrmuese të ndeshjeve kemi qenë ekip më i mirë, por në futboll nuk mjafton të luash mirë, duhet të fitosh. Kriza dhe rezultatet negative kanë qenë vetëm në tabelë", ka thënë Rexhepi, i cili vetëm një ditë më pas është zëvendësuar nga trajneri Severin Elezaj.

Kjo dorëheqje dhe as rikthimi i Elezajt nga ish-klubi nuk është diçka e re në futbollin e Kosovës, pasi tashme ndryshimi i trajnerëve është bërë modë në futbollin e Kosovës, duke u nisur nga Superliga e deri te rangjet më të ulëta. Kjo bëhet pasi pak klube nuk punojnë me plane afatgjata dhe menjëherë kur mungojnë rezultatet nuk i kursejnë trajnerët, duke i shkarkuar e në opinion duke i prezantuar si dorëheqje apo ndërprerje të bashkëpunimit me marrëveshje të dyanshme. Ndryshimin e shpeshtë të trajnerëve nuk arriti ta ndryshojë as pjesëmarrja e klubeve në garat e Ligës së Kampionëve dhe Ligës së Evropës, derisa në këtë edicion janë ndryshuar gjashtë trajnerë dhe pritet të ketë ndryshime të paktën edhe në dy klube të tjera. Prishtina dhe Vushtrria janë kampione për faktin se kanë ndryshuar nga dy trajnerë, kurse Dukagjini dhe Flamurtari kanë bërë vetëm nga një ndryshim. Prishtina me marrëveshje të dyanshme ndërpreu



bashkëpunimin me trajnerin nga Shqipëria, Mirel Josa dhe në vend të tij e emëroi Bylbyl Sokolin. "Profia" nuk qëndroi gjatë dhe dha dorëheqje me arsyen se ka probleme shëndetësore dhe i duhet të operohet. Vendin e trajnerit drejtuesit e klubit kryeqytetas vendosën t'ia besojnë një trajneri të ri, Armend Dallkut, që në fund të edicionit të kaluar u pensionua nga futbolli aktiv.

Ish-mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë e ka nisur mirë aventurën me skuadrën "bardhekaltër" dhe është në hap me skuadrat e para në renditjen tabelore. Skuadra tjetër nga kryeqyteti në fillim të edicionit aktual postin e trajnerit ia besoi Artim Shaqirit, i cili, pas

ndeshjes me Drenicën javën e kaluar, dha dorëheqje dhe vendin e tij në skuadrën e Flamurtarit e zuri Sunaj Keçi. Ndryshime interesante në këtë edicion të Superligës bëri skuadra e Vushtrrisë, e cila u rikthye në rangun elitare me shumë bujë. Fillimisht kjo skuadër postin e trajnerit ia besoi Bekim Shotanit, por pas disa xhirove atë e zëvendësoi me trajnerin italian Antonio Toma. Strategut italian nuk i ndezi puna për ta këndellur skuadrën e Vushtrrisë dhe vendin e tij e trashëgoi Fitim Llapashtica, i cili pati një debutim të suksesshëm. Dy trajnerët që rrezikojnë shumë të shkarkohen në javët në vazhdim janë Dejan Vukiqeviq i Feronikelit dhe Bekim Isufi i Dritës.

SHKURT

## Muriqi: Kisha ofertë nga Turqia, por zgjedha Kosovën

Sulmuesi Vedat Muriqi e ka pranuar se ka pasur ofertë për t'iu bashkuar Kombëtares së Turqisë U21. Ai ka thënë se në atë kohë erdhi ftesa e Përfaqësueses A të Kosovës dhe vendosi ta pranonte këtë të fundit. "Unë isha duke u përcjellë nga Turqia, por jo nga ekipi A. Bëhet fjalë për ekipin U-21 të Turqisë, pasi mua më donte trajneri Abdullah Ercan. Dokumentacioni ishte duke u proceduar, por më pas më erdhi oferta nga ekipi përfaqësues A i Kosovës dhe shkova për të luajtur për vendin tim", ka thënë Muriqi për mediet turke. Vedat Muriqi po shkëlqen me fanellën e Kosovës, por edhe me skuadrën e Fenerbahçes.

## Përforcohet KB Ylli

KB Golden Eagle Ylli ka paraqitur për regjistrim lojtarin ndërkombëtar Jalen Perry nga USA. Lojtari i lartpërmendur mund të regjistrohet në Federatën e Basketbollit të Kosovës dhe të paraqitet për KB Golden Eagle Ylli pas plotësimit të kriterëve në bazë të Rregullores mbi regjistrimin e lojtarëve në FBK.

## Xhaka rrezikon të humb shiritin e kapitenit të Arsenalit

Drejtimesit e Arsenalit do të takohen me kapitenin Granit Xhaka në ditët e ardhshme për të diskutuar për reagimin e ashpër teksa zëvendësohej në ndeshjen e së dielës me Crystal Palacen. Xhaka pritet të kthehet në ushtrime të martën para ndeshjes së Arsenalit në Carabao Cup në rrethin e katërt ndaj Liverpoolit. Kjo ndeshje zhvillohet të mërkurën. Federata Angleze s' do të marrë asnjë masë ndaj Xhakës që shau dhe bënte me gjeje ndaj fansave të Arsenalit që po fishkëllenin. Xhaka, që ka shkaktuar më së shumti ndërhyrje në Premier Ligë këtë edicion (22), është zëvendësuar në tri nga nëntë ndeshjet e Premier Ligës kur është paraqitur këtë sezon, raporton "Sky Sports". Nuk dihet akoma nëse Arsenali do të konsiderojë heqjen e shiritit të kapitenit nga Xhaka.

## Berisha, basketbollisti i javës në FIBA Euro Cup

PRISHTINË, 28 TETOR - Basketbollisti i Sigal Prishtinës, Dardan Berisha, është zgjedhur nga tifozët si lojtari më i mirë i xhiros së parë në grupet e FIBA Europe Cup. Prishtina mundi Apoel

Nicosia me rezultat 93:74, ku më i miri në parket ishte Berisha me 32 pikë, tetë asistime dhe dy vjedhje të topit. Dardani mori bindshëm më shumë vota se lojtarët e tjerë të nominuar. Për Dardan

Berishën votuan 55 % e tifozëve, 15 % mori Jeff Withey, nga 12 % Taylor Persons dhe Barry Stewart, kurse 6 % Michael Finke. Kështu Berisha, pasi u zgjodh në 5-shen e javës, u zgjodh nga

tifozët edhe lojtari më i mirë i xhiros së parë. Dardan Berisha është lider i Prishtinës dhe Përfaqësueses së Kosovës në basketboll, duke qenë një nga basketbollistët më të dalluar vendor në dekadën e fundit.



## Dukagjini rikthen trajnerin Severin Elezaj

KLINË, 28 TETOR - Skuadra e Dukagjinit nga Klina nuk ka humbur kohë dhe menjëherë e ka gjetur zëvendësuesin e trajnerit Xhengis Rexhepi, i cili vendosi të japë dorëheqje pas humbjes nga Ballkani (3-


0). Zëvendësuesi Rexhepi është Severin Elezaj, i cili edhe në të kaluarën e ka drejtuar me plot sukses skuadrën e Dukagjinit. "Pas një takimi me kryesinë e klubit është arritur një mar-

rëveshje që Elezaj ta drejtojë përsëri klubin tonë. Për disa vjet pjesë e klubit tonë dhe gjatë kësaj kohe nuk munguan as sukseset. Ai me klubin e Dukagjinit ishte dy herë radhazi në barazh për

Superligë. Pas dorëheqjes, afër një vit më parë, rikthehet si kryetrajner në klubin e qytetit, ku edhe si futbollist ishte aktiv për shumë kohë", thuhet në njoftimin e skuadrës nga Klina.



## Golden State pëson humbje nga Oklahoma



OKLAHOMA, 28 TETOR - Vjen fitorja e parë sezonale në NBA për Oklahoma City Thunderin, që mposhti thellë 120-92 Golden State Warriorsin. Një rezultat që certifikon nisjen shumë të keqe

të sezonit nga skuadra e Steve Kerrit, e cila duket shumë larg formës së viteve të fundit, ku ka siguruar pesë finale radhazi. Lamtumira e Durantit dhe dëmtimi i Thompsonit janë vetëm disa prej arsyeve të krizës, por perceptimi është që Golden State duhet të mendojë për një cikël krejt të ri dhe rruga për ta bërë duket shumë e gjatë. 23 pikë shënoi Stephen Curry për Warriorsin, ndërsa në radhët e Thunderit pesë basketbollistë

realizuan 10 ose më shumë pikë (më i miri Schroderi me 22 pikë). Koleksionuan fitoren e dytë Los Angeles Lakersi, që i imponua 120-101 Charlotte Hornetsit. Një ndeshje e fituar në periodën e katërt nga të zotët e shtëpisë, pasi shënuan një rezultat të pjesshëm 33-21. Funkcionon gjithnjë e më mirë dyshja LeBron James-Anthony Davis. I pari e mbylli me 20 pikë e 12 asistime, ndërsa i dyti me "double-double", 29 pikë e 14 "rebound".

### REZULTATET

Oklahoma - Golden State	120-92
Memphis - Brooklyn	134-133
Dallas - Portland	119-121
Minnesota - Miami	116-109
Lakers - Charlotte	120-101

## Pacquiao, Mayweather: Eja nëse dëshiron një sfidë të vërtetë boksi

MANILA, 28 TETOR - Boksieri Manny Pacquiao vazhdon të mos heqë dorë nga një revansh me Floyd Mayweather (filipinasi ka humbur sfidën e parë, në maj të vitit 2015). 41-vjeçari filipinas u shpreh se ai e dëshiron me çdo kusht këtë përballje të dytë me boksierin e pamposhtur amerikan. Një ofertë ka ardhur që ata të duelojnë vitin e ardhshëm, por ende nuk ka asgjë zyrtare. Përmes një postimi në faqen e vet zyrtare në "Twitter", boksieri filipinas shkruan: "Floyd Mayweather, nëse dëshiron të zhvillosh një revansh, një sfidë të vërtetë boksi, atëherë duelo me mua. Nëse dëshiron një duel 'show', atëherë duelo me mikun tim, Jack Ma, i cili do të kujdeset për ty. Unë jam gati në çdo kohë dhe në çdo vend të përballim me ty. Ekipi im është gati".



### SHKURT

#### 'Il Messagero': Ronaldo parakalon Messin dhe Van Dijkn

Cristiano Ronaldo përgatitet që ta fitojë për të gjashtë herë "Topin e Artë", të paktën kështu raporton "Il Messagero". Ronaldo ka parakaluar Messin dhe Van Dijkn dhe pritet të jetë ai fituesi i "Topit të Artë", që do të jepet më 2 dhjetor. Siç bën me dije kjo media, Ronaldo do të shoqërohet nga Fabio Paratiçi këtë mbrëmje dhe ka konfirmuar pjesëmarrjen në eventin e organizuar nga "France Football". 700 golat në karrierë dhe tre trofetë sezonin e shkuar (Liga e Kombeve, Kampionati në Itali, Superkupa në Itali) kanë bërë që Ronaldo të dalë mbi Van Dijkn dhe Messin, në këtë renditje.

#### Pjaniqi mungon një muaj

Mesfushori i Juventusit, Miralem Pjaniq, pësoi një lëndim në ndeshjen ndaj Lecces në fundjavë që "Zonja e Vjetër" e luajti baras 1-1. Mesfushori boshnjak u zëvendësua në pjesën e dytë pasi kishte problem me muskujt e pasmë të kofshës së djathtë, kurse pritet të mos jetë në dispozicion të Joves për katër javët e ardhshme. Besohet se Pjaniqi do të rikthehet për ndeshjen e 23 nëntorit ndaj Atalantës.

#### Wenger: Disa herë e kam refuzuar Francën


Ish-trajneri i Arsenalit, Arsene Wenger, ka pranuar se ka pasur mundësinë për t'u bërë trajner i Francës. Wengeri për momentin është pa ndonjë skuadër, pasi u shkarkua nga stoli i Arsenalit para dy sezoneve. Mirëpo, tekniku francez ka pranuar se ka refuzuar disa herë stolin e Kombëtares së Francës. "Disa herë e kam refuzuar Francën. Preferoj një klub futbollit. Me kombëtaren luajmë 10 ndeshje brenda një viti. Zakonisht i luaj 60, andaj nuk më ka pëlqyer", ka deklaruar Wengeri.

#### Icardi: PSG-ja, ekipi më i mirë ku kam luajtur

Mauro Icardi pretendon se Paris Saint-Germain është ekipi më i mirë në të cilin ka luajtur ndonjëherë, pas dy golave që i shënoi të dielën në fitoren e parisienëve kundër Marseille (4-0). "Jam i lumtur për golat dhe për fitoren. Kam luajtur me kampionë të mëdhenj, por ky ekip i PSG-së është më i miri për të cilin kam luajtur. Ndihej mirë dhe mund të shënoj gola", ka thënë Icardi, i cili është i huazuar nga Interi në PSG deri në fund të edicionit aktual.

#### Ribery kërkon falje që e shtyri gjyqtarin

Franck Ribery ka kërkuar falje që e ka shtyrë dhunshëm gjyqtarin anësor Matteo Passeri pas humbjes kontroverze të Fiorentinës 2-1 kundër Lazios. Veterani francez ishte i zemëruar pasi ishte zëvendësuar para se Lazio ta fitonte ndeshjen 2-1 në minutat e fundit. "Më vjen vërtet keq për mbrëmë. U kërkoj falje bashkëlojtarëve të mi, trajnerit dhe tifozëve. Po ashtu, i kërkoj falje edhe Matteo Passerit, sepse në fund të ndeshjes isha shumë i shqetësuar dhe trishtuar. Shpresoj se ai mund të më kuptoj", ka shkruar Ribery në "Twitter". "Unë gjithmonë dua të jem në fushë dhe t'u ndihmoj bashkëlojtarëve sepse erdha në Florencë për këtë qytet dhe për këtë klub. Mendoj se Fiorentina duhet të marrë më shumë vëmendje, vëmendjen e njëjtë që e marrin klubet e tjera, për punën që po e bëjmë çdo ditë", ka shtuar Ribery.

	<b>Autor:</b> <b>GAZMEND MORINA</b>	QË BESON VERBËRISHT NË DOGMËN FETARE	ZBËRTHIM I NJË ÇESHTJE	PIJE FRESKUESE E ATHËT (sh.shq.)	SOLISTJA ... BYTYQI	SPIUNIA E FAMSHME ... HARI	<b>EPOKA E RE</b>	NDESH	ANTON PASHKU	KOMANDANT I NJË ANUJEJE	SFOND SHKRONJASH	FAREFISI (bised.)
	LUTEM (fet.)						HEROI ZEJNULLAHU					
	SHPIRTI (Lat.)							PANDJESI I PËRQESHUR				
	PËSHPËRIT FJALË MAGJIKE								PRAPA KRUIJA, APOLONIA			
	PËRGJIGJE NË TELEFON					AGIM TEJECI AZEM BEJTA			SHTET NË AMERIKË FALJE QË BËJNË DISA HERË NË DITË MYSLIMANËT			
	KËNGËTARJA ... TARNER						RROGA VJETORE E PAPËS ELIZA DUSHKU					SHKENCA QË STUDION METODAT DHE MJETET E HETIMIT E TË ZBULIMIT TË KRIMEVE
	AKTORJA E FAMSHME ITALIANE ROSSELLINI (shqip.)								"E" para dy "K" HYJNI E DASHURISË (mit. romake)			
MUZIKANTI AMERIKAN ... ROCK					RE E DENDUR TYMI SHUMË E GJATË						BASHKËT. UDHËHEQËSI I NJË PARTI POLITIKE	
<b>EPOKA E RE</b>	KËNGËTARJA AMERIKANE NË FOTO	JONI ME NGARKESË NEGATIVE	NËNREPART USHTARAK I PËRBËRË PREJ DISA TOGASH	ENË PËR TË NXJERRË UJË NGA BUNARI (shq.) FUTBOLLIST PORTUGEZ	IGLI TARE	"A" në mes të dy "M" PJESE E FORTË E BUKËS (sh.shq.)		KORNIZË VËNIA E MINAVE			BRUS ... TATUAZH (bised.)	
QË SHPREHET ME PAK FJALË E NË MËNYRË TË PRERË							KAMION I VOGËL QË KA TË BËJË ME FSHATINË, FSHATARESKE			FJALË E DHËNË PËR DIÇKA KANAPE E GJERË DHE E GJATË		
PËRTËRITËS								RIDERS (shk.) MARK ANTONI			KËNGËTARJA ROZANA ... ZANORE	
PORT DETAR					SHTET NË EVROPE MJET UDHËTIMI E TRANSPORTI (shq.)					NGJYRË E FYTYRËS NOTË MUZIKORE		
KING OF PRUSSIA				PËRSËRITËS (gram.) PJESE E EPËRME E DHOMËS							ILUZIONISTI SHQIPTAR NADIR ... RENS ISTVUD	
MËRI, ZILI				REOMIR, TANTAL SHKRIMTARI HAZIRI (shq.)			AKTORI EGJIPTIAN SHARIF (shq.) LLOJI I LETËRSISË EPIKE				IRMA LIBOHOVA ROBERT REDFORD	
KULLË E XHAMISË						DIKTATUR RUS				RAVENA DUKAT		ZANORE BOSHT
JAM I DENJË TË NDEROHEM E VLEJ TË MË JEPET NJË ÇMIM A NJË SHPËRBLIM	FUTBOLLISTI KROAT KLASNIÇ PARIA E SHOQËRISË					EPOSI VEPRIMTARI I SHQUAR PETRO ... LUARASI		MJET PUNE (shq.)	REKUIZITË SPORTIVE (shq.)	NËPËR ARA, ARAVE PËREMËR VETOR		
BASHKË, TOK (bised.)			"ASHTU QOFTË" KALIBËR I TYTËS SË ARMËS			QË NXË NJË OKË (PËR ENËT) BËRTHAMOR						KASTRIOT TUSHA SPORT LUFTARAK
SHKRIMTARJA KADARE					I BËJ APEL ZANORE						KNOWLEDGE SYSTEMS INSTITUTE NJËSI PESHE PËR GURËT E ÇMUAR	
RITUAL				SHKRIMTARI ALIGIERI LËNDË MËSIMORE				PERIUDHË E GJATË DHE E RËNDËSISHME HISTORIKE VENDËS, RRËNJËS				BASHKËT. NDËRRIM I MALLIT
VENDLINDJA E ODISEUT					DY ZANORE ISLANDA		KALI I STËRVITUR MA JEP				KËNGËTARJA BAJRAMI ANNAPOLIS PERFORMANC E SAILING	
KRYEQYTETI I ESTONISË						HUQ, VES VARIOLË				BUJK BASHKËT.		TEDI ALVES
OSAKA		NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE ZANORE			SUPER MODELJA ADRIANA BASHKËT.				ARMË E FTOHTË PREJ ÇELIKU (sh.shq.) ONTARIO			
RILINDËSI ... VRETO				PIKTORI PABLO						EMBLEMA		

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Kushtrimi AD 1" Sh.p.k Rogovë, Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për seperimin e inerteve në vendin e quajtur "Bellajat-Butsina" në Rogovë komuna e Gjakovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 25.11.2019 në ora 11:00 në lokalet e kompanisë "Kushtrimi AD 1" Sh.p.k në Rogovë të Hasit komuna e Gjakovës do të organizohet debat publik nga kompania "Kushtrimi AD 1" Sh.p.k Rogovë, Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për seperimin e inerteve në vendin e quajtur "Bellajat-Butsina" në Rogovë komuna e Gjakovës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "BNo1" Sh.p.k Mitrovicë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin për riciklimin e mbeturinave sipas kodit 190805, 191212, 040222, 160103 në Shupkovc komuna e Mitrovicës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 26.11.2019 në ora 13:00 në hapësirat e restorant "Verona" të parku industrial "Trepça" Mitrovicë do të organizohet debat publik nga kompania "BNo1" Sh.p.k Mitrovicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin për riciklimin e mbeturinave sipas kodit 190805, 191212, 040222, 160103 në Shupkovc komuna e Mitrovicës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Razim Cokli"

Komuna: Shtërpçë

Data: 29.10.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/104-CS/1.1	Trajnim: Zbatim i TI në mësimdhënje

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP)*, dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe SHFMU "Razim Cokli" Brod, Shtërpçë.

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

**Trajnim: Zbatimi i Teknologjisë Informative në mësimdhënje (World, dhe Power Point)**

#### Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvojë në trajnimin dhe punën me personelin e administratës publike ose komunale
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë:

#### Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo IT (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

#### Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesimit për shërbime konsulente në adresën: SHFMU "Razim Cokli" Brod, Shtërpçë. më së largu deri më 06.11.2019.

1. 4. Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

#### Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Bektesh Bajrami

Telefoni: 045593226 / 049929107

E-maili: b\_24viqa@hotmail.com



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/giejpuneshpejite

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit - Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës - Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 126/19 Dt. 22.10.2019 Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren - Prizren Belediyesi

Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti  
KOMUNA E PRIZRENIT  
Kryetari i Komunës  
Nr. 01-126/19  
Datë: 22.10.2019

Në bazë të nenit 4 paragraf 2, pika 2.4.3.5. të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-205 të dt: 28.10.2010, Organi Shpronësues-Kryetari i Komunës së Prizrenit pas shqyrtimit të Kërkesës së Drejtorisë për Administratë me nr.02-464-135540 të dt: 20.09.2019, me qëllim të realizimit të Projektit për Ndërtimin e Varrezave në Krushë të Vogël, nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 të dt: 20.02.2010, nenit 13, 109 si dhe nenit 82 të LPA-së nr.02/L-28 të dt:22.07.2005, merr këtë:

**V E N D I M**

**I. PRANOHET** si qëllim i ligjshëm publik dhe e bazuar kërkesa për shpronësimin e pronave të paluajtshme në ngastrat kadastrale më të cilën duhet të bëhet Ndërtimi i Varrezave në Krushë të Vogël, me të dhënat e përshkruara sipas kërkesës së Drejtorisë për Administratë, nr. 02/464-135540 të dt: 20.02.2019.

**II.** Ngastrat kadastrale të cilat do të shpronësohen për realizimin e këtij projekti gjenden në ZK Krushë e Vogël dhe atë: ngastrat kadastrale nr.321-0 ZK Krushë e Vogël, ku pjesa e sipërfaqes për shpronësim është 3386 m<sup>2</sup> nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7292 m<sup>2</sup>, pronë e bashkëpronarëve: 1/9 Ibrahim (Arif) Shehu, 3/9 Nuredin (Qazim) Shehu, 3/9 Abdyll (Qazim) Shehu, 1/9 Sadik (Arif) Shehu dhe 1/9 Ismail (Arif) Shehu si dhe ngastrat kadastrale nr.323-0 ZK Krushë e Vogël, ku pjesa e sipërfaqes për shpronësim është 58 m<sup>2</sup> nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7253 m<sup>2</sup>, pronë e Stevan (Jovan) Nikoliq.

**III.** Kërkesa për shpronësim në fjalë do të shqyrtohet në procedurë të mëtejme me qëllim të Realizimit të projektit për Ndërtimin e Varrezave në ZK Krushë e Vogël.

**A r s y e t i m**

Drejtorija për Administratë me kërkesën e vet nr.02-464-135540 të dt: 20.09.2019, ka kërkuar shpronësimin e pronave të paluajtshme të cekura si në kërkesën e datës të cekur si më lartë, të cilat gjenden në ZK Krushë e Vogël sipas fletës poseduese me të dhënat e përshkruara më afër në kërkesën për shpronësim nga Drejtorija për Administratë.

Subjekti kërkuar me rastin e paraqitjes të kësaj kërkesë, të njëjtës ia ka bashkangjitur të gjitha dokumentet e nevojshme që parashihen në dispozitën e nenit 8, paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, me nr. 03/L-205 të dt: 28.10.2010 të Republikës së Kosovës dhe atë:

- kërkesën për shpronësim,
- listat poseduese dhe kopjet e planit për parcelat e shpronësuar,
- dokumentin për disponueshmërinë e mjeteve financiare.

Organi shpronësues - Kryetari i Komunës ka pranuar kërkesën në fjalë të Drejtorisë për Administratë për shpronësimin e ngastrave kadastrale me të dhënat e përshkruara si në kërkesë, ku kësaj kërkesë i është bashkangjitur edhe dokumenti përmes të cilit dëshmohet se Komuna e Prizrenit ka siguruar mjete të mjaftueshme financiare për pagimin me kohë të kompensimit në emër të shpronësimit të pjesëve të pronave të paluajtshme sa i përket realizimit të projektit.

Duke qenë se kërkesa në fjalë është e bazuar u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi dhe në pajtim me nenin 8 paragraf 5 lidhur me nenin 4, të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme nr. 03/L-205 të Republikës së Kosovës.

Me këtë Vendim njoftohet:  
Subjekti kërkuar  
Arkivi  
Pala

Organi Shpronësues:  
Kryetari i Komunës  
Prof. Dr. Mytaher Haskuka

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit - Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës - Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 126/19 Dt. 22.10.2019 Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren - Prizren Belediyesi

Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti  
OPŠTINA PRIZREN  
Predsednik Opštine  
Br. 01-126/19  
Dana: 22.10.2019

Në bazë të nenit 4, paragraf 2, tačka 2.4.3.5., Zakona za Izmenu i Dopunu Zakona Br. 03/L-139 za Eksproprijaciju Nepokretne Imovine Br.03/L-205 od dana: 28.10.2010, Ekspropriacioni Organ - Predsednik Opštine Prizren nakon razmatranja zahteva Direktorijata Administracije sa br. 02-464-135540 od dana: 20.09.2019, u cilju realizacije Projekta za Izgradnju Groblja u Maloj Kruši, člana 13 Zakona za Lokalnu Samoupravu br.03/L-040 od dana: 20.02.2010, člana 13, 109 kao i člana 82 ZAP br. 02/L-28 od dana:22.07.2005, donosi ovu:

**O D L U K U**

**I. PRIMA SE** kao zakonski javni cilj i osnovan zahtev za eksproprijaciju nepokretnih imovina na katastarskim parcelama sa kojim treba da se izvrši izgradnja Groblja u Maloj Kruši, sa opisanim podacima prema zahtevu Direktorijata Administracije, br. 02/464-135540 od dana: 20.02.2019.

**II.** Katastarske parcele koje će se ekspropiirati za realizaciju ovog projekta nalazi se na KZ Mala Kruša, i to: katastarska parcela br. 321-0 KZ Mala Kruša, gde je površina za eksproprijaciju 3386 m<sup>2</sup> od opšte površine od 7292 m<sup>2</sup>, imovina suvlasnika: 1/9 Ibrahim (Arif) Shehu, 3/9 Nuredin (Qazim) Shehu, 3/9 Abdyll (Qazim) Shehu, 1/9 Sadik (Arif) Shehu i 1/9 Ismail (Arif) Shehu kao i katastarska parcela br. 323-0 KZ Mala Kruša, gde površina za eksproprijaciju je 58 m<sup>2</sup> od opšte površine od 7253 m<sup>2</sup>, imovina Stevana (Jovan) Nikolić.

**III.** Zahtev za navedenu eksproprijaciju razmatraće se u daljnoj proceduri u cilju realizacije projekta za izgradnju Groblja u KZ Maloj Kruši.

**O b r a z l o ž e n j e**

Direktorijata za Administraciju na svoj zahtev br. 02-464-135540 od dana: 20.09.2019, je tražio eksproprijaciju navedene nepokretne imovine kao u zahtevu gore navedenog datuma, koja se nalazi u KZ Mala Kruša po posedovanom listu sa približno opisanim podacima u zahtevu za eksproprijaciju od Direktorijata Administracije.

Tražen subjekat povodom dostavljanja ovog zahteva, s istim je dostavio sve potrebne dokumente koji se predviđaju u odredbi člana 8, paragrafi 2 i 3 Zakona za Izmenu i Dopunu Zakona br. 03/L-139 za eksproprijaciju nepokretne imovine, sa br. 03/L-205 od dana: 28.10.2010 Republike Kosova i to:

- Zahtev za eksproprijaciju,
- Posedovani listovi i kopije plana za ekspropiirane parcele,
- Dokumentat za raspoloživost finansijskih sredstava.

Ekspropriacioni organ - Predsednik Opštine je primio zahtev Direktorijata Administracije za eksproprijaciju katastarskih parcela sa opisanim podacima kao u zahtevu, gde je sa zahtevom dostavljen i dokumentat preko kojeg se dokazuje da je Opština Prizren osigurala dovoljno finansijskih sredstava za isplatu na vreme nadoknade na ime eksproprijacije dela nepokretnih imovina što se tiče realizacije projekta.

Imajući u vidu da navedeni zahtev je osnovan, odlučeno je kao u dispozitivu ove Odluke i u skladu sa članom 8 paragraf 5 u vezi sa članom 4 br. 03/L-205 Republike Kosova.

Ovom Odlukom upoznati:  
Podnosioca zahteva  
Arhivu  
Stranku

Ekspropriacioni Organ:  
Predsednik Opštine  
Prof. Dr. Mytaher Haskuka

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit - Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës - Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 126/19 Dt. 22.10.2019 Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren - Prizren Belediyesi

Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti  
PRIZREN BELEDIYESI  
Belediye Başkanı  
No. 01-126/19  
Tarih: 22.10.2019

03/L-205 sayılı 28.10.2010 tarihli Taşınmaz Malların Kamulaştırılmasına dair 03/L-139 sayılı Yasanın Değiştirilmesi ve ilave edilmesine ilişkin Yasanın 4.maddesi 2.fıkrası, 2.4.3.5. noktası gereğince, Prizren Belediye Başkanı-Kamulaştırma Makamı olarak Yönetim Müdürlüğün 02-464-135540 -Resmi sayılı ve 20.09.2019 tarihli talebini görüşüldükten sonra Küçük Kruşa'da Mezarlıkların İnşaa edilmesine Projesinin gerçekleştirilmesi amacıyla, 03/L-040 sayılı 20.02.2010 tarihli Yerel ÖZ Yönetim Kanun'un 13. ve 109.maddesi, ayrıca 02/L-28 sayılı 22.07.2005 tarihli LPA 82.maddesi gereğince şu karara varıldı:

**K A R A R**

**I.** Yönetim Müdürlüğü 02/464-135540 sayılı ve 20.02.2019 tarihli talebi gereğince tanımlanan Küçük Kruşa'da Mezarlıkların İnşaa edilmesine projesinin gerçekleştirilmesi için gerekli olan kadastral parsellerinde gayrimenkul mülkiyetlerin kamulaştırılması ile ilişkin talep asıllı olarak ve yasal kamusal amaçlı olarak **KABUL EDİLMİŞTİR.**

**II.** Projenin gerçekleştirilmesi için kamulaştırılacak olan kadastral parselleri Küçük Kruşa'nın KB bölgesinde bulunurlar şöyleki: Küçük Kruşa KB 321-0 sayılı kadastral pakseli, 1/9 Ibrahim (Arif) Shehu, 3/9 Nuredin (Qazim) Shehu, 3/9 Abdyll (Qazim) Shehu, 1/9 Sadik (Arif) Shehu ve 1/9 Ismail (Arif) Shehu ortak mal sahiplerin 7292 m<sup>2</sup> genel alanından 3386 m<sup>2</sup> alan ve Küçük Kruşa KB 323-0 sayılı kadastral pakseli, Stevan (Jovan) Nikoliq mülkiyeti olan 7253 m<sup>2</sup>lik genel alanından 58 m<sup>2</sup>lik alan kamulaştırılacaktır.

**III.** Söz konusu kamulaştırma talebi Küçük Kruşa'da Mezarlıkların İnşaa edilmesi projesinin gerçekleştirilmesi amacıyla ilerki süreçte görüşülecektir.

**A ç ı k l a m a**

Yönetim Müdürlüğü 02-464-135540 sayılı ve 20.09.2019 tarihli talebi ile, yukarıda belirtilen kamulaştırma talebinde daha ayrıntılı olarak tanımlanan gayrimenkul mülkiyetler, Yönetim Müdürlüğü tarafından emlak belgesi gereğince Küçük Kruşa KB bulunan gayrimenkul mülkiyetlerin kamulaştırılmasını talep etti.

Talebi sunan oluşum işbu talebi sunarken aynısına Kosova Cumhuriyetinin 03/L-205 sayılı 28.10.2010 sayılı Taşınmaz Malların Kamulaştırılmasına dair 03/L-139 sayılı Yasanın Değiştirilmesi ve ilave edilmesine ilişkin Yasanın 8.maddesi 2. ve 3. fıkrası hükümleri gereğince öngülen gerekli tüm belgeleri de eklemiştir ve o da şu şekilde:

- Kamulaştırma talebi,
- Sahiplik listeleri ve kamulaştırılan parsellerin plan kopyaları,
- Maddi kaynakların var olduğuna dair belge.

Kamulaştırma Makamı-Belediye Başkanı tanımlanan verilerle kadastral parsellerin kamulaştırılması için Yönetim Müdürlüğün söz konusu talebini kabul etti, işbu talebe Prizren Belediyesinin projeyi gerçekleştirmekle ilişkin gayrimenkul mülkiyet kısımlarının kamulaştırılmasına adına tazminatı zamanında ödeyecek şekilde finansal kaynakların yeterli olduğunu temin ettiğini doğrulayan belge de eklemiştir.

Talep asıllı olarak bulunduğu için Kararın giriş kısmındaki hüküm ayrıca Kosova Cumhuriyetinin 03/L-205 sayılı 28.10.2010 tarihli Taşınmaz Malların Kamulaştırılmasına dair 03/L-139 sayılı Yasanın Değiştirilmesi ve ilave edilmesine ilişkin Yasanın 4.maddesi ile ilişkin 8.maddesi 5. fıkrası uyarınca karar verilmiştir.

Karar ile bildirilmeli:  
Talep eden oluşum  
Arşiv  
Taraf

Kamulaştırma makamı:  
Belediye Başkanı  
Prof. Dr. Mytaher Haskuka

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës - Kosovo Doctors Chamber - Lekarska Komora Kosova

**FTESË PËR OFERTË**

**Lloji i Kontratës:**  Furnizim  Shërbime  Punë

Nr. i Prokurimit 09-19

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbrojnë veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimin më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën **Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë**, apo përmes emailit: **info@omk-rks.org**, me titullin:  
**Dosja për: Kontratë për Auditim Funkcional dhe Financiar të OMK-së**

Në pajtim me Nenin 8, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

**Afatet Kohore.**

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së tenderit është: **04.11.2019 ora 14:00.**  
Afati i fundit për aplikim në tender është: **06.11.2019 ora 14:00.**  
Hapja e ofertave bëhet me datën: **08.11.2019 ora 14:00.**



Në pajtim me nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Paneli për përzgjedhjen e anëtarit joekzekutiv të Bordit të BQK-së, publikon:

### Ri-Shpallje

Për pozitën e një anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Profili i kërkuar:

- Person me integritet dhe përgatitje universitare;
- Minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale ose akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitet apo çështje juridike;
- Njohuri në krijimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të rëndësishme të lidhura me misionin, objektivat dhe detyrat e BQK-së;
- Në mënyrë specifike të plotësojnë kushtet sipas nimit 40 të Ligjit nr. 03/L-209 për BQK-ën;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve tjera paraqet përparësi.

Emërimi do të jetë për një mandat pesëvjeçar duke filluar nga data e emërimit.

Lista e kandidatëve që kualifikohen nga ana e Panelit do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili do të përzgjedh një individ. Miratimi dhe emërimi për këtë pozitë do të bëhet nga Presidenti i Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 84 paragrafi 27, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 38 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-209 për BQK-ën.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një CV me detaje dhe një letër motivuese përmes email adresës vijuese: [paneli@bqk-kos.org](mailto:paneli@bqk-kos.org) ose në dorë në zarf të mbyllur në arkivin e BQK-së, Rruga Garibaldi nr. 33 në Prishtinë, ose përmes postës në adresë të BQK-së: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (shënim: për pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të BQK-së), Rruga Garibaldi nr. 33,1000 Prishtinë, Kosovë.

Afati i fundit për aplikim është 13 nëntor 2019, në orën 16:00.

Vetëm kandidatët e të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit do të thirren për intervistë.

### Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Halit Geci"

Komuna: Skenderaj

Data: 29.10.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/112-CS/1.1	Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe "Halit Geci" Llaushë, Skenderaj.

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktivitetëve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie (Internet, Outlook, Acces)

#### Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe përsonele të shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme.

#### Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

#### Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit Janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën "Halit Geci" Llaushë, Skenderaj, më së largu deri më datën; 06.11.2019

Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

#### Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Shefqet Geci

Telefoni: 044/957/047

E-maili: [shefqet.geci@hotmail.com](mailto:shefqet.geci@hotmail.com)

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Drini i Bardhë Fatjon SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811304451 Vushtrri.

► "OIL Distribution" SH.P.K shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 71100510 dhe numër unik identifikues 810842494.

► Kërkoj shporet për nxehtë qendrore me dru të përdorur, që mundet të ngrohe deri 1000 m2, numri kontaktues 044-608-626.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokalit është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokalit gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



U skladu sa članom 38. Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj Banci Republike Kosovo (CBK), Panel za izbor neizvršnog člana Odbora CBK-a, objavljuje:

### PONOVNI OGLAS

Za poziciju jednog neizvršnog člana Odbora Centralne Banke Republike Kosovo

Traženi profil:

- Osoba sa integritetom i univerzitetskim obrazovanjem;
- Minimum deset (10) godina profesionalnog ili akademskog iskustva u oblastima ekonomije, finansija, banaka, računovodstva ili pravnih pitanja;
- Znanje u stvaranju i nadgledanju sprovođenja značajnih politika vezanih sa misijom, ciljevima i obavezama CBK-a;
- Da specifično ispunjavaju uslove u skladu sa članom 40. Zakona br. 03/L-209 o CBK-u;
- Poznavanje engleskog i drugih jezika predstavlja prednost.

Imenovanje će biti u petogodišnjem mandatu, počev od dana imenovanja.

Lista kandidata koji se kvalifikuju od strane Panela dostaviće se Skupštini Republike Kosovo, koja će izabrati jednog pojedinca. Usvajanje i imenovanje za ovu poziciju će se obaviti od strane Predsednika Republike Kosovo u skladu sa članom 84. stav 27. Ustava Republike Kosovo i člana 38. stav 2. Zakona br. 03/L-209 o CBK-u.

Zainteresovani kandidati treba da dostave CV sa detaljima i motivaciono pismo putem sledeće email adrese: [paneli@bqk-kos.org](mailto:paneli@bqk-kos.org) ili na ruke u zapečaćenoj kovrti u arhivi CBK-a, ulica Garibaldi br. 33 u Prištini, ili putem pošte na adresu CBK-a: Centralna Banka Republike Kosovo (napomena: za poziciju neizvršnog člana Odbora), ulica Garibaldi br. 33,1000 Priština, Kosovo.

Poslednji rok za apliciranje je 13 novembar 2019. godine, u 16:00 časova.

Samo kandidati koji ispunjavaju uslove konkursa će biti pozvani za intervju.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria -Vlada-Government*



*Ministria e Mbrojtjes*  
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense  
Drejtoria e Burimeve Njerëzore / Direktorat Ljudskih Resurs  
Human Resources Directorate

# KONKURS

**PËR REKRUTIMIN E KADETËVE PËR SHKOLLIM NË AKADEMINË E FORCAVE AJRORE  
DHE AKADEMINË USHTARAKE –WEST POINT TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS**

**Afati i konkurimit:**

**Konkursi është i hapur prej 22.10.2019 deri më 04.11.2019.**

**Ministria e Mbrojtjes iu shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës  
dhe mirëpret aplikacionet e të gjithë kandidatëve të interesuar  
pa dallim gjinie, race dhe përkatësie etnike.**

Konkursi dhe formularët për aplikim janë në dispozicion në Komandën e Forcave Tokësore  
dhe në ueb-faqen e Ministrisë së Mbrojtjes, [www.mod.rks-gov.net](http://www.mod.rks-gov.net).  
Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në nr.tel. 038-603-355.

